



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË
KOSOVËS, TË MBAJTUR MË 15 SHKURT 2012**

**PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA, ODRŽANE
15. FEBRUARA 2012. GODINE**

**SHKURT – FEBRUAR
2012**

E mërkurë, 15 shkurt 2012

Drejton seancën, nënkryetari i Kuvendit të Kosovës, zoti Xhavit Haliti

KRYESUESI: Të nderuar, mirë se keni ardhur!

Së pari, kërkoj falje sepse sistemi i elektronikës është prishur. Emrat e atyre që janë paraqitur për diskutim, janë shlyer krejt. Për dy emra, e di dhe janë përfaqësuesit e Grupit Parlamentar të LDK-së, i kanë emrat në listë të dorëzuar.

Atëherë, të nderuar deputetë,

Të nderuar përfaqësues të Qeverisë,

Hap punimet e mbledhjes plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Rendi i ditës është përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me grupet parlamentare.

Para se të fillojmë me pikat e rendit të ditës, ftoj deputetët që me një minutë heshtje t'i nderojnë viktimat që humbën jetën nga orteku i borës në fshatin Restelicë të komunës së Dragashit.

(Mbahet një minutë heshtje)

I përjetshëm qoftë kujtimi i tyre!

Para se të hyjmë në shqyrtimin e rendit të ditës, është një kërkesë e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, deri diku e harmonizuar, ose si nevojë e kohës edhe me grupet tjera parlamentare.

Ftoj zotin Adem Grabovci, që ta shtrojë kërkesën në foltoren e Parlamentit.

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar kolegë,

Ne jemi dëshmitarë që pardje ka ndodhur një ngjarje në veri të vendit, mbajtja e një referendumi ilegal, siç është vlerësuar edhe siç është realitet edhe i kundërshtuar nga gjithë faktori ndërkombëtar, por edhe nga Qeveria e Republikës së Kosovës. Ne, sot kishim një konsultë me të gjithë shefat e grupeve parlamentare, prandaj unë këtu në emër të gjithë grupeve parlamentare i propozoj Kuvendit, që të lëshojmë një deklaratë, të cilën pas një pauze të shkurtër që do të na jepet, ne do ta harmonizojmë tekstin dhe do t'ua prezantojmë juve për ta votuar. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Atëherë, unë propozoj që pas shqyrtimit të pikës së katërt të rendit të ditës, të marrim gjysmë ore pauzë, në të cilën shefat e grupeve parlamentare do të harmonizojnë këtë çështje dhe në qoftë se mund ta harmonizojnë edhe tekstin edhe qëndrimet, si pikë e pestë e rendit të ditës të hyjë deklarata e propozuar më parë.

Po e qes në votim formal.

Kush është për? Faleminderit!
A ka kundër? S'ka. Faleminderit!

Konstatoj se në pajtim me të gjithë deputetët prezentë të Kuvendit të Kosovës, si pikë e pestë e rendit të ditës do të jetë: **Shqyrtimi i Deklaratës së propozuar për miratim nga Kuvendi i Kosovës**, propozuar nga kryetari i Grupit Parlamentar të PDK-së.

Tani po vazhdojmë me pikën e parë:

1. Koha për deklarime, jashtë rendit të ditës

Unë kam një problem me teknikën, ju kisha lutur grupeve parlamentare ose deputetëve, që t'ia japin me shkrim sekretarisë emrat, sepse kompjuteri doli nga sistemi dhe e kanë marrë ata, që të kam mundësi t'i harmonizoj për kohën sa i kushtohet kësaj pike të rendit të ditës.

Pak më herët, me kërkesë të deputetes Duda Balje dhe me miratim të kryetarit të Kuvendit, i është lejuar fjala në fillim të seancës, për shkak të ngjarjeve që kanë ndodhur, që në emër të Grupit Parlamentar ta marrë fjalën.

DUDA BALJE: Zahvaljujem!

Tragično, subotnjeg jutra u selu Restelica, velika snežna lavina odnela je deset života. Deseta žrtva pronađena je juče u toku poslepodneva. Sreća u celoj ovoj velikoj tragediji je preživjela petogodišnja devojčica Amsera Reka, koja se osjeća dobro i koja je sa svojom familijom.

Ovo je jedan od dokaza da priroda uvek učini ono što naumi, ali je takođe bio dokaz ljudske spremnosti, osjećajnosti, humanitarnosti i solidarnosti cele naše države, koju sam ja, kao i mnogi drugi mogli videti na delu, u danu kada se nesreća dogodila, danom posle pa sve do jučerašnjeg dana, kada je poslednja žrtva bila pronađena.

Koristim priliku da se javno, u svoje ime i ime porodice Balje, i čitave moje zajednice, zahvalim svim hrabrim ljudima iz sela Restelice, koordinatore kriznog štaba i imama Šabanu Hađiu, svim ljudima iz cele Gore, sela Kruševo, Globočica, Zlipotoka, koji su peške ručno čisteći zavejane snežne puteve došli na mesto događaja i dali deo sebe u akciji spašavanja nestalih. Zahvaljujem se ljudima, koji su došli iz župe, čim su čuli za nesreću i dali veliku fizičku i moralnu podršku.

Zahvaljujem se premijeru, gospodinu Hashimu Thaçi i zamjeniku premijera Haradinu Kuçi u svemu što su uradili u vremenu posle dešavanja nesreće, u cilju što bržeg pronalaženja unesrećenih.

Zahvaljujem se Policiji Kosova, zahvaljujem se vama ministre Agime Čeku, sa kojim smo stalno bili u kontaktu. I svim vašim ljudima koje ste poslali na terenu, njihovoj hrabrosti, profesionalnosti, organizovanosti, momentima njihove nesebičnosti, kada su

svoje žvite stavili u rizik da bi spasili druge. Upravo je ta nesebičnost rezultirala spašavanjem jednog dragocjenog života.

Vama ministre Fehmi Mujota, koji ste lično od prvog dana bili u prilici da zajedno sa nama budete sve dok tragičnog momenta nestane i akcije spašavanja.

Zahvaljujem se čelnicima opštine Prizren, koji su nam stavili na raspolaganju sva sredstva koja su posedovali, u cilju olakšavanja akcije pronalaženja nestalih i naravno opštini Dragaš, gradonačelniku Saljemu Jonuziju, zamjeniku gradonačelnika Časipu Kuči, predjedniku skupštine Ljuljzimu Rifaju i svim strukturama opštine.

Veliku zahvalu upućujem i zamjeniku Husminu Baldiju, na svim aktivnostima i pomoći, koju je pružio.

Zahvaljujem se medijima i svima koji su u najtežim trenucima bili sa nama i delili strepnju, neizvesnost i strah ishoda nesreće.

I posle svega viđenog sam sigurnija nego ikada da iako smo mala država, imamo ljude sa velikim srcima i velikom hrabrošću. Ovom prilikom izjavljujem saučešće svim članovima porodice preminulih. Neka im dragi alah podari sabor, a njihovim najmilijim dženet.

Dužna sam da napominjem i to da smo uz pomoć FSK-a uz stalnu koordinaciju sa ministrom gospodinom Agimom Čeku i gospodinom Tafiljom Avdija, u doku jučerašnjeg dana, poslali pomoć u lekovima, hrani, baterijskim lampama i svim drugim potrebštinama, šestočlanoj porodici Balje, u mestu Barbole, između sela Restelice i Zlipotoka, koji poseduju veliku farmu i koji odbijaju evakuaciju. Pomoć im je poslata i slaće im se u kontinuitetu sve dok im bude bila potrebna.

I, naravno, zahvaljujem se predsednici Atifete Jahjaga na pruženoj podršci porodici Reka! Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së është paraqitur Idriz Vehapi.

IDRIZ VEHAPI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Të nderuar zëvendëskryeministra,

Ministra,

Të nderuar deputetë,

Unë do të flas lidhur me një çështje e cila është ngritur kohëve të fundit që ka të bëjë me ndotjen e tokave bujqësore.

Të nderuar deputetë,

Kohëve të fundit janë ngritur shqetësime për ndotjen e tokës bujqësore në Kosovë, prandaj do të doja që si përfaqësues të popullit ta trajtojmë këtë çështje gjithnjë duke pasur parasysh interesin publik. Natyrisht, nuk duhet që ne sot të pretendojmë të japim

konstatime se sa është shkalla e ndotjes, nuk duhet as të japim konstatime për shkallën e rrezikut potencial për shëndetin e njeriut, por ne duhet të tërheqim vëmendjen për nevojën, përkatësisht domosdoshmërinë e interpretimit të kujdesshëm dhe kompetent të rezultateve të hulumtimeve dhe të raportimit të tyre në publik.

Pa dashur të bëj ndonjë analizë të detajshme dhe profesionale shkencore sot në këtë sallë të Kuvendit, sepse kjo duhet të ngjajë në institucione kërkimore, shkencore dhe tryeza shkencore, megjithatë më duhet t'i përmend në mënyrë telegrafike elementet kyçe të raportit të cilat do të duhej t'i pasqyronin të gjeturat reale të hulumtimit dhe të cilat duhet të jenë elementet kryesore që do të ndikojnë në perceptimin e publikut dhe në rrjedhën e debatit për këtë temë.

Në këtë kontekst, vështrimi të cilin do ta paraqes, pashmangshëm është i ndikuar edhe nga sfondi profesional. Në përmbledhje të raportit flitet, tash do të përmend disa citate, disa thënie që janë në përmbledhjen e raportit dhe të cilat na tregojnë se gjendja nuk është aq serioze si është paraqitur në media.

- “Brendë potenciale për transferim e mundshëm të ndotësve në zinxhirin e ushqimit të njeriut.” – kjo nuk është ndonjë konstatim shkencor.
- “Rezultatet nuk duhet të përgjithësohen për tërë tokat bujqësore në Kosovë.” Edhe kjo është e vërtetë, sepse nuk guxojnë të përgjithësohen rezultatet.
- Thënia tjetër: “Jo vetëm ndotja, por edhe kualiteti i tokës, ndikon në rendimentet, përkatësisht parametrat e matura.” Dhe, kjo është e vërtetë, sepse nuk mund të merret një bimë për test biologjik dhe të konstatohet pastaj gjendja se është alarmante në tërë territorin e Kosovës.
- Pastaj thuhet: “Së paku një pjesë e tokës bujqësore është e kontaminuar.” Kjo dihet, sepse tokat bujqësore përreth gjigantëve industrial çdoherë janë të kontaminuar.
- Dhe, po ashtu thuhet se një pjesë e ndotjes i atribuohet sfondit gjeogjen.” edhe kjo është e ditur për shkencën, sepse zonat minerare, përbërja e përbërësve të metaleve të rënda është para se të ndikojë faktori antropogjen, domethënë, nuk ka të bëjë me efektin e faktorit njeri.

Për më tutje, në këtë hulumtim janë fituar të dhënat për efektin e vetëm të një bimë dhe atë në parametra kuantitativ. Këtë e thotë edhe raporti i këtij projekti. Pra, ka nevojë që të testohen edhe organizma të tjerë dhe hallka të tjera të zinxhirit të ushqimit. Domethënë, nuk mund këto rezultate të përgjithësohen, sikurse është pretenduar në disa shkrime të gazetave ditore.

Në raport thuhet edhe kjo: “Ky projekt duhet të jetë vetëm hap i parë që të hulumtohet toka bujqësore në Kosovë.” Kjo është e mirë diçka, sepse ne duhet të bëjmë analiza edhe të mëtejme për këtë problem.

Nga ana tjetër, në opinion është krijuar një perceptim shumë më dramatik për efektet e ndotjes bujqësore, për shkak se raporti, përkundër vlerësimeve të përgjithësuara, që vetë i përmend dhe i thekson në disa raste, jep konstatime të përgjithësuara, të cilat nuk kanë

mbështetje të duhur në të gjeturat e vet hulumtimit. E këtij perceptimi i ka kontribuar vetë hartuesi i raportit, i cili në njërën anë kërkon që të mos bëhen përgjithësime, ndërsa në anën tjetër vetë e bën këtë.

Dhe, pikërisht këto konstatime, këto...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, fjalën e ka deputetja Hykmete Bajrami.

HYKMETE BAJRAMI: Të nderuar kolegë deputetë,

Unë në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së po e ngris një çështje që e meriton vëmendjen e të gjithë neve, institucioneve të vendit dhe qytetarëve të Kosovës.

Kjo që do të shpalos edhe një herë tregon se deri ku mund të shkojë kjo Qeveri me abuzimin me ligjin. Nuk kanë kaluar as dy muaj kur ky Kuvend, pa votat e LDK-së dhe të opozitës, kaloi Ligjin e buxhetit për vitin 2012, ku janë të përcaktuara projektet ku do të shpenzohen paratë e tatimpaguesve brenda një viti.

Të premten e kaluar në Kuvend erdhi një dokument ku Qeveria vetëm për informim të Kuvendit e solli për ndryshimet e buxhetit. Në këtë dokument, me fjalë të tjera, Qeveria tregon se në cilat projekte po shkel Ligjin e buxhetit, të aprovuar pikërisht nga ky Kuvend.

Vetëm një muaj pas aprovimit të këtij ligji të buxhetit dhe ende pa filluar të shpenzohen paratë e këtij buxheti, Qeveria ka vendosur të ndërrojë buxhetin e 58 projekteve, në vlerë prej 8 milionë e 327 mijë euro. Vetëm në infrastrukturën rrugore, nëpër komuna ndryshimet janë me vlerë prej 4.200.000 euro. Brenda programit të infrastrukturës, vetëm Podujevës i merren 600.000 euro dhe gjysma e tyre i barten Skenderajt. Po ashtu, Prishtinës i merren 1.350.000 euro në dy projekte dhe shuma të tjera, në projekte të tjera. Nga këto ndryshime komunat e PDK-së janë përfituesit më të mëdhenj, kurse ato të LDK-së janë të diskriminuarat. Komuna e Skenderajt përfiton afër 1 milion euro vetëm në projektet e infrastrukturës. Problemi qëndron, se ato projekte të cilave iu bartet buxheti, nuk janë projekte të reja, por janë projektet dhe obligimet që kanë mbetur të papaguara nga Qeveria dhe nuk i janë prezantuar këtij Kuvendi, si të tilla.

Nuk ka fije dyshimi se po shkelet Ligji i buxhetit. Shkurtime që janë bërë në 58 projekte, nuk përkojnë me nenin 7 të këtij ligji, sepse këto shkurtime nuk na vijnë nga bilancet e pashpenzuara, siç e përcakton neni 7 i Ligjit të buxhetit. Këto mjete janë të marra nga projekte të ndryshme dhe barten për t'i kryer obligimet e papaguara. Për ilustrim po përmendim shkurtime të buxhetit për rrugën Pejë-Prishtinë, shkurtime të buxhetit për unazën e jashtme të Prishtinës dhe rrugë të tjera.

Këto veprime të Qeverisë në largim paraqesin shkelje të ligjit dhe mosrespektim të votës së Kuvendit, sepse dikush i ka dhënë vetit të drejtë të investojë, të ndërtojë rrugë dhe

shkolla, pa mjete të zotuara, kurse Qeveria tani po tenton të paguajë për abuzimet e ligjit. Në këtë formë Qeveria po zhytet dyfish në shkelje të ligjit, këto ndryshime i thellojnë pabarazitë në mes të komunave dhe qytetarëve të vendit. Me këto ndryshime Kuvendi po i legalizon veprimet diskriminuese dhe antiligjore të kësaj Qeverie.

Unë pyes Qeverinë, pse duhet të ndërrohet buxheti i rrugës Pejë-Prishtinë, në shumë prej 997 mijë euro?

Pse duhet të shkurohet buxheti i unazës së jashtme të Prishtinës, apo vetëm pse Qeveria, komunën e Prishtinës e sheh si komunë të qeverisur nga LDK-ja dhe jo si kryeqytet ku qarkullojnë çdo ditë një e katërta e qytetarëve të Kosovës.

Përse duhet të mbulohen keqpërdorimet e ministrive, ku është shteti ligjor apo ligji, nuk vlen për pozitën, por vlen vetëm për ta burgosur opozitën?

Ne jemi të shqetësuar se si po menaxhohet buxheti i këtij shteti. Kjo shkelje e ligjit dhe manovrim me shifra po ndodh ngase Ministria e Infrastrukturës dhe disa ministri të tjera kanë hyrë në obligime prej dhjetëra miliona euro për punët që i kanë kryer vitin e kaluar, pa ndonjë bazë ligjore. Si kanë pasur mundësi dhe të drejtë ministrat të bëjnë investime dhe të krijojnë obligime pa mjete të zotuara? Për shkelje të tilla dikush duhet të shkojë në burg e jo t'i mbulohen veprimet. Duhet të përgjigjet edhe Ministria e Financave. Edhe me këto sjellje kjo Qeveri po dëshmon edhe njëherë se është vënë mbi Kuvendin, ajo po i dërgon investimet atje ku dëshiron e jo aty ku i ka përcaktuar Kuvendi.

Ne ju ftojmë që ky Kuvend të refuzojë çfarëdo ndryshimi në buxhet. Do ta ftojmë edhe Fondin Monetar Ndërkombëtar ta konsiderojë këtë situatë, ftojmë edhe institucionet ligjore. Çfarëdo ndryshimi duhet të jetë i bazuar në ligj dhe i arsyetuar plotësisht në aspektin ekonomik dhe social.

Ne ftojmë edhe një herë këtë Qeveri të pakicës që t'i trajtojë njësoj të gjithë qytetarët e Kosovës. Ajo nuk ka të drejtë t'i diskriminojë qytetarët mbi baza politike dhe të shkelë ligjin. Ky vend nuk meriton të qeveriset nga shkelësit e ligjit. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Zoti Liburn Aliu, në emër të Grupit Parlamentar të lëvizjes “Vetëvendosje”.

LIBURN ALIU: Të nderuar deputetë,

Gjendja e rëndë në Kosovë që po mbretëron këto ditë nga të ftohtit dhe bora po shkon vetëm duke u përkeqësuar. Patëm 10 të vdekur dhe numri i të lënduarve nga aksidentet e përditshme po shkon gjithnjë e në rritje. Çdo ditë e më tepër kemi rrugë të bllokuara dhe vendbanime të izoluar, shtëpi të dëmtuara dhe rrezikim të mundshëm nga viktimat nga hipotermia.

Kjo gjendje e rëndë dhe ky përkeqësim është e qartë që e zuri Kosovën dhe mekanizmat e saj institucional të papërgatitur, por kjo nuk do të duhej të ishte arsyeja e së tërës, pra të përmbillet çdo gjë përbrenda këtij arsyetimi, është e domosdoshme të ndërmerret më

tepër. Deri tani FSK-ja me mekanizmat e saj të kufizuara po përpiqet t'u dalë në ndihmë qytetarëve dhe po e kemi të qartë se potenciali i saj sado i vlefshëm, është i pamjaftueshëm dhe që kjo të kompensohej do të duhej të kishin ndihmë më të madhe nga KFOR-i, nga të cilët, përveç ndihmës që na ofron përmes billbordave gjithandej në Kosovë, do të donim të shihnim më tepër së paku gjysmën e asaj që e shohim në billborda.

Po ashtu, besoj që KFOR-i do t'i demantojë mediumet gjermane ditë më parë që raportnin punën e KFOR-it dhe të EULEX-it, në Restelicë, në gjetjen e trupave të pajetë dhe ku FSK-ja nuk përmendej fare. E në këtë situatë të rëndë, Serbia e Maqedonia, po bëjnë garë marketingu se kush do t'i paguajë pension më të lartë vajzës Amsera Reka, të mbijetuar nga orteku në Restelicë. E të gjitha këto fakte të ndërthura në disa ditë na e bëjnë të qartë se e kemi tejet të nevojshëm një mobilizim qytetar për të tejkaluar këtë situatë. Mobilizimi i tillë qytetar u dëshmuar në Restelicë dhe nëse na mungojnë sot ndihmat nga të tjerët dhe tenderët për pastrimin e rrugëve nuk po bëjnë punë, është e domosdoshme të ndërmerret diçka më tepër dhe të gjejmë mundësitë brenda vetes, mundësia e shpalljes së gjendjes së jashtëzakonshme është atributi kryesor i sovranitetit të një shteti. Dhe, si një shtet sovran që e quajmë veten, do të duhej të bënim një gjë të tillë, shpresoj, që nuk është shqetësimi nga opinionet e ndërkombëtarëve shkak i mos shpalljes së kësaj gjendje të jashtëzakonshme.

Në hapjen e rrugëve dhe në ndihmën e qytetarëve të izoluar do të duhej të aktivizoheshin qytetarët, kompanitë e rrugëve, nga një thirrje për solidarizim dhe pushteti qendror e lokal t'i mbulonte shpenzimet e derivateve dhe të siguronte ushqim të ngrohtë e veshmbathje e pajisje për qytetarët e mobilizuar që do të punonin. Mobilizimi i tillë, përpos që do të përmirësonte gjendjen nga dëbora, do të rriste solidaritetin mes qytetarëve dhe do t'ua shtonte besimin atyre në forcën e vet dhe do ta bënte të qartë madhësinë e forcës së qytetarëve. Një gjë e tillë do të mund t'i pengojë dikujt, por kjo është tejet e rëndësishme për Kosovën. Ka shumë vende që situatat e tilla i përdorin si shanse për ngritjen e mobilizimit qytetar brenda tyre dhe tërë kësaj duhet të mos harrojmë t'ia shtojmë që Ushtria e Republikës së Shqipërisë në këto momente të rënda ka ofruar ndihmën e saj dhe kjo ndihmë është tejet domethënëse për Kosovën.

KRYESUESI: Faleminderit!

Fjalën e ka deputetja Biserka Kostiq.

BISERKA KOSTIĆ: Zahvaljujem!

Poštovani potpredsedniče,

Vladini Kabinet,

Međunarodni predstavnic,

Ministri,

Poštovani kolege poslanici,

Na osnovu poglavlja 5. tačka 4., 5. tačka 7., 9. tačka 1, 2, 6. ustavnog okvira za privremenu upravu na Kosovu donetu 15 maja 2001.godine, u cilju poštovanja jezičkih identiteta svih pojedinaca, stvaranja okruženja za sve zajednice da mogu da se izraze i da štite svoj identitet a bazirajući se na međunarodnoj Konvenciji o zaštiti građanskih i

političkih prava i Evropskoj konvenciji o zaštiti ljudskih prava donet je zakon o upotrebi jezika, službenih jezika i pisma na Kosovu, gde se kaže da su albanski i srpski jezik, zvanični jezici na Kosovu kao i njihovi alfabeti.

Gospodo poslanici, svrha ovog zakona je da obezbedi ravnopravni status albanskog i srpskog jezika, kao službenih jezika na Kosovu. Da obezbedi jednaka prava za njihovu upotrebu u svim institucijama Kosova, kako bi zajednice mogle da očuvaju održe i promovišu svoj jezički identitet.

Poštovane kolege poslanici, moramo biti iskreni i reći da zakon, koji je na snazi ne krši i ne zadire prava u interesu zajednica na Kosovu. Ali isto tako moramo priznati da postoje drastična kršenja istog zakona. Počevši od kršenja jezika, korišćenju jezika u centralnim institucijama, zatim opštinskim institucijama, javnom sektoru, kao i u privatnom sektoru.

Sve ovo govorim iz razloga zato što je kršenje ovog zakona došlo do te mere da povređuje ljudsko dostojanstvo. I ukoliko se nešto u najkraćem roku ne preduzme, postojace samo jedan zvanični jezik na Kosovu.

Postoje mnogi negativni primeri, koji potvrđuju ovu konstataciju. Trebalo bi mi puno vremena ukoliko bih želela sve da ih nabrojim.

Zato ću navesti samo neke od primera, koji su tako vidljivi da se sami nameću. Kao što su: upotreba ćirilicnog pisma u samoj Skupštini Kosova. Natpisi, koji označavaju imena gradova, opština, sela, ulica kao i imena ostalih mesta, na žalost samo su na albanskom jeziku, jer je srpska verzija izbrisana crnom farbom ili markerima.

Neko će reći da su to uradili huligani, koji ne žele dobro Kosovu. I ja se slažem sa tom konstatacijom. Ali gospodo, to traje već mesecima, da ne kažem godinama. I niko ne preduzima odgovornost da te iste natpise ponovo vrati u okvire zakona, to jest da opet budu dvojezični. Ali da bismo i to opravdali ne bismo trebali da imamo znakove kod kojih su promenjena imena naselja i koji su napisani isključivo samo na jednom zvaničnom jeziku.

Takođe, što se uvoznih proizvoda ili proizvoda za širu upotrebu tiče, kao što su prehrambeni proizvodi ili lekovi, ne mogu a da ne naglasim da su deklaracije istih proizvoda isključivo na albanskom jeziku. Tako da potrošači koji kupuju te iste proizvode, ukoliko ne znaju albanski jezik ne znaju šta kupuju.

Zato vas, gospodo poslanici, molim da ako je moguće uložimo više napora i pokažemo dobru volju da se ovi problemi reše i da se poštuje zakon na svim nivoima. Da se krivci za ovakvo stanje kazne, jer mislim da ne donose dobro Kosovu, jer time se šalje jasna poruka manjinama da se oni ne mogu integrisati u kosovsko društvo i da su im osnovna prava ugrožena. Zahvaljujem!

KRYESUESI: Faleminderit!

Deputetja Suzan Novobërdaliu e ka fjalën.

SUZAN NOVOBËRDALIU: Faleminderit!

I nderuar kryesues,

Të nderuar deputetë,

I nderuar Kabinet qeveritar,

Shqetësimet tona janë lidhur me raportin e Komisionit Evropian në ULLUP, përkrahja e mëtejme e shfrytëzimit të tokës, se është konstatuar kontaminimi i tokës bujqësore mbi normat e lejuara me metale të rënda, në veçanti: krom, nikel, plumb, zink dhe arsenik.

Ndaj këtij raporti kemi pasur dy deklarata kundërhënëse të ministrave të ministrive përkatëse, ministrit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, në njërën anë, se nuk ka ndotje dhe në anën tjetër të ministrit për Planifikim Hapësinor, se ka ndotje. Ky raport, që krijon shqetësim na bën me dije se nga toka e helmuar ne konsumojmë ushqim të helmuar. Gjithashtu, kjo jo vetëm që nxit shqetësimin e opinionit, por edhe ndikon në trendët edhe kështu të kufizuara të eksportit kosovar.

Raportet e tilla dëmtojnë imazhin e prodhuesve vendor, sidomos eksportin e prodhimeve bujqësore. Prandaj, ju bëj thirrje të dy ministrave kompetentë, të ministrive kompetente, që urgjentisht të angazhojnë ekspertë dhe kapacitete tjera të nevojshme që të bëjnë hulumtime për të vërtetuar saktësinë e pranisë së metaleve të rënda në tokë, në rajonet tona, duke kryer analiza të tokës konform standardeve që parashihen në laboratorë serioze të BE-së, me metodologji korrekte të marrjes së mostrave në gjithë Kosovën, me qëllim të qartësimit të situatës lidhur me këtë raport. Me këtë raport të njoftohet opinioni dhe Kuvendi. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Deputeti Hamza Balje e ka fjalën.

HAMZA BALJE: Zahvaljujem, predsedavajući!

Poštovan Vlada kabinet,

Poštovani građani Republike Kosova,

Kolege zastupnici,

11 februar 2012.godine, pamticemo svi po tragičnom događaju, koji je zadesio Restelicu, koji je zadesio Republiku Kosovo, koji je zadesio cjeli kosovski narod. Ali zasigurno, mogu ovdje, sa ove govornice rječi da je tog dana cjelo Kosovo bilo Restelica. Ne štjedeći se niti hladnoće, niti umora razmišljajući kako će uspjeti pronari žive svoje drage komšije, prijatelje i rodbinu.

Tračak nade se pojavio u srcima svih prisutnih na tragičnom mestu, kada su specijalne jedinice FSK-a, izvukli djevojčicu Amseru živu i zdravu. Svi su pohitali poslom vjerujući da će biti još preživjelih. Ali, ništa. I poslednji tračak je izgubljen, kada su pronađena preostala životna tjela. Rezultat tog kobnog događaja je nesretna pogibija desetoro naših sugrađana, izazvana snežnom lavinom.

Ovo je veliko iskušenje, koje je zadesilo naše unesrećene porodice, naše sugrađana Resteličane, sve bošnjake i gorane Republike Kosova, kao i sve narode, koji žive u našoj mladoj državi. Za devetoro ukućane i familije Reka i u prisustvu više hiljade građana sa

cjele teritorije Kosova i pristiglim im članovima familije, komšije i prijatelja, obavljena je dženaza, odnosno sahrana u zajedničkoj grobnici na seoskom groblju, dok će danas biti obavljena dženaza i posljednjem nastradalom članu familije Reka, Resminu Reka.

Ovom prilikom želim da se zahvalim svim mještanima cele Restelice i svim ostalim pojedincima, koji su pokazali veliku solidarnost i humanost u ovim teškim trenucima u akciji spašavanja nastradalih. Velika zahvalnost pripada institucijama Republike Kosova, Vlade Republike Kosova, pripadnicima FSK-a, policiji, vatrogasnoj službi, jedinicama KFOR-a, naročito turskog KFOR-a, kao i svim predstavnicima u institucijama Republike Kosova, koji su pod teškim vremenskim uslovima do poslednjeg trenutka učestvovali na spašavanju nastradalih.

Vjerujem i ne sumnjam u to da će Vlada Republike Kosova, Parlament naše države ali i svi mi u Parlamentu Republike Kosova, u najskorijem vremenu pomoći Restelici u izgradnji i saniranju porušenih kuća, u izgradnju infrastrukture, koji nedostaju, puteva, vodovoda, ambulate, u školovanju mladih kadrova, koji će biti uzor našoj mladoj državi, kako bi se i resteličani osjećali svoji na svome i formirali dugo očekivanu opštinu.

Edhe një herë ju falënderoj të gjithëve për kontributin që keni dhënë në këto ditë të vështirë për Restelicën. Besoj, që gjithmonë do të jemi me familjen Reka, e cila do të ketë përkrahje prej neve dhe prej institucioneve të Republikës së Kosovës. Ju faleminderit, shumë!

KRYESUESI: Faleminderit!

Deputetja Emilija Rexhepi e ka fjalën.

EMILIJA REDŽEPI: Zahvaljujem, potpredsedniče skupštine!

Neizrečiva je tragedija, koja je ovih dana pogodila meštane Restelice, sav bošnjački i goranski narod. Celo Kosovo je u šoku gledajući potresne snimke žrtava, koje su stradale u prirodnoj katastrofi i sigurni smo da ne postoji niko ko se u ovom trenutku ne suosjeća sa vašim bolom.

Poštovani građani, dozvolite mi da u svoje lično ime kao i u ime Nove Demokratske Stranke, našem članu Hađikamberu Balje i njegovoj porodici, uputim iskreno osećanje našeg dubokog saučešća, gubitkom njegove čerke sa celokupnim članovima familijom Reka. A preživjeloj maloj Amseri želimo brže ozdravljenje i oporavak.

Kao zajednica, odajemo zahvalnost svim meštanima Restelice, ministru Mujoti, Kosovskim bezbednosnim snagama, Ministarstvu unutrašnjih poslova, genaralu turskom i nemačkom KFOR-u, odnosno svima onima, koji su pod jako teškim vremenskim uslovima učestvovali u akcijama spašavanja poginulih žrtava i spasili jedan dečiji život. Zahvaljujem!

KRYESUESI: Faleminderit!

Fjalën e ka zoti Ismet Beqiri.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Sigurisht edhe ne e shprehim keqardhjen dhe ngushëllimet tona si Lidhje Demokratike për të gjithë ato familje që pësuan në ngjarjet e Restelicës.

Të nderuar deputetë, kolegë,

Edhe njëherë, në emër të Grupit Parlamentar, ju drejtohem juve dhe qytetarëve me një shqetësim që e kemi jo vetëm ne si grup parlamentar, për atë që ndodhi ditë më parë me rastin e heqjes së fotografisë së presidentit Ibrahim Rugova nga salla ku mbahen mbledhjet e Kryesisë. Si Grup Parlamentar e dënojmë një akt të tillë, që është i papërgjegjshëm, i pandërgjegjshëm dhe shumë i dëmshëm. Me këtë, jo që dikush mund të denigrojë personalitetin e presidentit Ibrahim Rugova, por e denigron veten. Dhe, kush ka qenë dhe kush mbetet presidenti Rugova, unë nuk do të flas sot, sepse e dinë të gjithë, e kanë thënë qytetarët, e kanë thënë edhe shumë burra shtetesh më të mëdhenj se ata që e kanë hequr dhe janë të vegjël ta vlerësojnë personalitetin e tij.

Andaj kërkojmë që fotoja e presidentit që është më shumë se sa fotografi, të kthehet aty ku e ka vendin. Ne e dimë çfarë thotë në ligj se duhet të vendoset fotografia e presidentit aktual, por askund nuk shkruan se duhet të hiqet fotografia, në këtë rast e presidentit Rugova. Andaj, të respektosh të tjerët edhe të kaluarën, do të thotë të respektosh edhe të tashmen edhe të ardhmen. Ata që këtë nuk e bëjnë, nëse mendojnë se tërë jetën do të jenë ulur ku janë aktualisht e kanë shumë gabim. Personaliteti i presidentit, vepra dhe jeta e tij kanë mbetur dhe do të mbesin gjithmonë në mendjen e qytetarëve tanë.

Andaj, si Grup Parlamentar i LDK-së dhe si Lidhje Demokratike e Kosovës do t'i përdorim të gjitha metodat institucionale që kjo fotografi të kthehet dhe të mos luhet në këtë formë me personalitetin e tij, sepse nuk është hera e parë, në këtë Kuvend ka ndodhur diçka e tillë edhe më keq në prag të shpalljes së pavarësisë, sikundër që ka ndodhur edhe në Ministrinë e Kulturës. Këto janë veprime të papërgjegjshme, unë ju lus që t'i ktheheni ndërgjegjes ju që jeni përgjegjës për këtë dhe mos na tregoni se si po e respektoni ligjin, kur paligjësia në tërë territorin e Kosovës është prezente dhe paska mbetur që këtu të respektohet ligji.

Kjo është me të vërtetë absurde, sepse për personalitetet siç është presidenti Ibrahim Rugova, por edhe vetë komandanti legjendar Adem Jashari, këto ligje i shkruan populli dhe ato që shkruhen edhe thuhën nga disa të tjerë, janë më së paku qesharake. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Deputeti Nait Hasani e ka fjalën.

NAIT HASANI: Përshëndetje, kolegë të nderuar!

Ne si Komision e kemi prurë një raport për tokën bujqësore, mendoj që atë ditë kur e kemi lexuar raportin e Komisionit për tokën bujqësore, shumica e Kuvendit as që e ka dëgjuar dhe kanë bërë hajgare me raportin.

Po, në momentin që u bë publike që në Kosovë paska helmim të tokës nga shtypi jonë, unë mendoj që ky shtyp që s'di kujt i shërben, për mua është një vepër terroriste që i ka bërë tokës së Kosovës dhe qytetarëve të Kosovës, bujqve tanë. Është për të qeshur, ndoshta për disa deputetë të cilët nuk ia dinë rëndësinë dhe vlerën, sepse pikërisht produktet tona sa patën marrë mundësinë e daljes në treg edhe më këto i shkatërruam dhe i izoluam. Nuk e di kush janë ata, megjithëse e dimë në formë interne kush janë, që e kanë bërë këtë publike dhe e kanë kërkuar pikërisht që të quhet tokë e helmuar toka e Kosovës, ku ne kemi thënë se Kosova ka tokë të ndotur nëpër vende të caktuara ku është zhvillimi i industrisë.

Prandaj, ne kemi edhe mostra të produkteve nga shtetet fqinje që i kanë bërë të produkteve dhe ato mostra tregojnë që shteti i Malit të Zi i pranon këto produkte pikërisht dhe thotë se nuk janë të ndotura, nuk janë të helmuara, nuk janë të kontaminuara.

Nëse e marrim, për shembull, raportin e doganës së Vërmicës, të datës 31 dhe raportin e Institutit për laborator të Malit të Zi, thotë: "Plumb ka 0.1 që është sasia, ndërsa maksimumi është deri në 0.10.

Kjo do të thotë që e kemi shumë, shumë të ulët sasinë e elementeve të ndotjes në produktet tona, ndërsa ne vet apo shtypi jonë i cili nuk ia do të mirën vendit të vet, dhe punon për të huajt, punon për shërbime të huaja dhe për kë di unë, ata e helmojnë dhe shkatërrojnë pronën tonë.

Prandaj, unë kisha kërkuar që nga Kuvendi, t'i jepet mundësi Komisionit për Bujqësi që të kërkojë të krijohet një komision që do të ketë ekspertë të cilët do të merren me vlerësimin e tokës bujqësore dhe do të merren mostrat në ato pika ku i ka pasur projekti EULE dhe do të vlerësohet se cila është gjendja e tokës.

Prandaj, ne kemi edhe dokumente tjera që dëshmojnë pikërisht se toka jonë nuk është e helmuar, por mund të jetë e ndotur në vende industriale, por megjithatë toka jonë është shumë prodhuese dhe shumë e pastër për prodhimet tona.

Prandaj, kërkojmë nga Kuvendi, po edhe nga Qeveria për gjetjen e këtyre të shtypit që i kanë bërë dhe e kanë kallë gjithë opinionin tonë dhe bujqit që i kanë shkatërruar, të merren në përgjegjësi dhe të shkarkohen nga pozicionet politike. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! I fundit është zoti Konjufca. Jo, nuk e doni fjalën! Atëherë minutazhi ka përfunduar për pikën e rendit të ditës në fjalë. Në emër të Qeverisë, fjalën e ka kërkuar ministri Bedri Hamza.

MINISTRI BEDRI HAMZA: Ju faleminderit, zoti kryesues!

I nderuari zoti kryesues,
Kabinet qeveritar,
Të nderuar deputetë,

U ngrit një çështje që ka të bëjë me Ligjin e buxhetit. Dihet që buxheti për Republikën e Kosovës është aprovuar në seancën e këtij Kuvendi me datën 20 dhjetor dhe për këtë ligj kanë votuar shumica e deputetëve të këtij Kuvendi. Ky ligj është aprovuar me mbi 60 vota.

Ministria e Financave ka vepruar në përputhshmëri të plotë me Ligjin e buxhetit. Dhe, ju kisha lutur referojuni nenit 7 të Ligjit të buxhetit, paragrafi 2 dhe të gjitha ndryshimet janë bërë në harmoni me nenin 7, paragrafi 2 të Ligjit të buxhetit.

Dihet që buxhetin organizatat buxhetore, të nivelit lokal dhe qendror brenda Ministrisë së Financave e dorëzojnë në muajin shtator, apo deri në fund të muajit shtator, me qëllim që të ka mundësi që të procedohet brenda muajit tetor në Qeveri.

Është vështirë që me precizitetin më të madh në atë kohë të vlerësohet për realizmin fizik të disa projekteve. Prandaj, për këtë qëllim është lënë mundësia që në bazë të nenit 7 paragrafi 2 të Ligjit të buxhetit, organizatat buxhetore të kenë mundësi t'i bëjnë ndryshime në projektet, në tabelën 3.2 dhe 4.2. Prandaj gjithçka është në harmoni dhe në përputhshmëri të plotë me Ligjin e buxhetit. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Zoti Mujota, e ka fjalën!

FEHMI MUJOTA: Ju faleminderit, i nderuari kryesues!

Të nderuar anëtarë të Kabinetit të Qeverisë,

Të nderuar deputetë,

Ministri Hamza, veçse i nxori para deputetëve faktet që çdo ndryshim që ka ndodhur sa u takon projekteve që i ka miratuar ky Kuvend, kanë ndodhur në përputhje me ligjin. Dhe unë nuk dua të përmend gjëra tjera përveç asaj që projektet e miratuara në këtë Kuvend dhe projektet e realizuara deri më tash në Kosovë janë projekte të qytetarëve të Kosovës, nuk janë të orientuara mbi bazat partiake dhe nuk janë të orientuara mbi bazën e dëshirës ose vullnetit të dikujt, por mbi bazën e Ligjit dhe nevojës së qytetarëve.

Ky Kuvend i ka miratuar të gjitha projektet të cilat kanë afat të zbatimit më tepër se një vit. Vite më përpara, projektet të cilat kanë filluar kanë vazhduar dhe do të vazhdojnë deri në përfundimin e tyre edhe në vitin 2012.

22 projekte janë projekte të bartura nga vitet e mëparshme dhe Kuvendi i ka votuar ato projekte dhe nuk do të ndryshojnë për asnjë pikë e për asnjë presje nga këto projekte. Dhe unë po përmendi projektet të cilat janë në vazhdimësi, për hir të informimit të publikut dhe për hir të shqyrtimit të deputetëve që e ngriti këtë çështje.

Ndërtimi i urës në Viti, është në vazhdimësi. Ndërtimi i urës në fshatin Sopi, ndërtimi i urës mbi lumin Drenica, ndërtimi rreth rrotullimit te stacioni i autobusëve, rehabilitimi i rrugës Prishtinë-Pejë, rehabilitimi i rrugës Prishtinë-Mitrovicë, ndërtimi i rrugës Klinë-Turiqevc, rikonstruimi i rrugës Rezallë-Tushillë, rikonstruimi i rrugës Tomoc-Kovragë, ndërtimi i rrugës Kofile-Kraçaliz-Qirez, rikonstruimi i rrugës Suharekë-qender-Studenqan, rruga lidhëse R126 Podujevë-Pollatë, rikonstruimi i rrugës Gorancë-Hani i

Elezit, ndërtimi i rrugës Skenderaj-Vushtri, zgjerimi i rrugës regjionale Prizren-Landovicë, ndërtimi i rrugës Vojtesh-Lubovec, ndërtimi i rrugës Stan-Trg-Melenicë-Vllahi, ndërtimi i rrugës Podujevë-Ballovc-Herticë, ndërtimi i rrugës Shipashnicë-Desivojc në kufi, ndërtimi i rrugës tranzitore në Shtime, rikonstruimi i rrugës Hogosht-Rogoçicë, dhe asfaltimi i rrugës në fshatin Qubrel.

Këto janë projekte të cilat përkojnë të përcillen me buxhetin e Republikës së Kosovës dhe ne jemi të interesuar që mos të lejojmë borxhe për vite të tjera.

Projektet e reja të cilat duhet të ndërtohen dhe përsëri të prekin gjeografinë e gjithë Kosovës, po i përmend me këtë rast.

Rehabilitimi i rrugës Prishtinë-Mutivodë, segmenti Kolaj - Keçekollë është një projekt i cili do të bashkë financohet nga Qeveria dhe nga komuna e Prishtinës. Rehabilitimi i rrugës Batllavë-Orllan, ndërtimi i rrugës në Vitomiricë, ndërtimi i rrugës në Ranillug, ndërtimi i rrugës në fshatin Majanc-Lupç i Epërm-Popovë, asfaltimi i rrugës në fshatin Zallc të Istogut, asfaltimi i rrugës në fshatin Surigan, projekti i bashkëfinancimit do të jetë në komunat, ndërtimi i rrugës Prizren-Reçan-Pouskë-Jabllanicë, asfaltimi i rrugës Lutogllavë, Sverkë e Thatë dhe ndërtimi i unazës së jashtme, pjesa perëndimore e Prishtinës.

Për hir të informimit të publikut, projektet të cilat tani më figurojnë në hartën e projekteve për vitin 2012, të gjitha do jenë të realizuara.

Dhe unë dua të përmend një fakt që gati çdo i dyti deputetë, edhe pas miratimit të buxhetit, ka bërë kërkesa shitesë, kërkesa të veçanta në të mirë të komunitetit, në të mirë të lagjes, të fshatit dhe të tjerë dhe të gjithë duhet të kenë parasysh se cilat janë mundësitë buxhetore, dhe unë i mirëpres të gjitha propozimet. Sepse, kemi lënë të hapur çdo mundësi që të financojmë edhe më tutje për projekte të caktuara dhe me rishikimin e buxhetit, unë pres kontributin tuaj që t'i përcillni kërkesat që do të sjellë Ministria e infrastrukturës për t'i realizuar këto projekte.

Me të vërtetë besoj në sinjeritetin tuaj që t'i përkrahni këto projekte dhe t'i realizojmë të gjitha.

Komuna e Prishtinës do të udhëheqë "Projektin e unazës perëndimore" vet. Është një qasje e re në këtë drejtim dhe unë besoj se është e drejtë. Të gjitha mjetet të cilat do të ndahen për komunat, do të bëj maksimumin që të barten drejtpërdrejtë te komunat, ato t'i udhëheqin edhe procedurat dhe t'i përcjellin projektet e tyre në mënyrë që të kemi një transparencë më të madhe të shpenzimit të buxhetit dhe të kemi edhe një përcjellje më kualitative të realizimit të punimeve. Prandaj në këtë drejtim, nuk ka nevojë të kemi asnjë shqetësim.

Deputeti Liburn Aliu, e ngriti çështjen e mirëmbajtjes së rrugëve dhe çështjet tjera, që besoj se e kanë vendin për t'u diskutuar dhe për hir të informimit dua të sqaroj për disa gjëra.

Që nga fillimi i të reshurave të borës në Kosovë, të gjitha rrugët magjistrale dhe rajonale në Republikën tonë kanë qenë të kalueshme. Nuk mund të thuhet se ka pasur rrugë të bllokuara dhe tani do të bëjë edhe një sqarim, se fjala “bllokadë” dhe fjala “pengesë” kanë dallim të madh. Do të kemi kujdes kur i përdorim ato dhe si i përdorim ato.

Rrugët magjistrale dhe rajonale në gjatësi prej rreth 2.000 kilometrave, që janë përgjegjësi e Ministrisë së Infrastrukturës, sipas gjendjes reale dhe asaj që po flasim edhe nga raporti i fundit tash që e kam para 5 minutave, janë të kalueshme dhe do të përmendi segmentet të cilat kanë vështirësi dhe të cilat janë arsytet e vështirësive.

Po ashtu gjatë gjithë kohës, segmenti i autostradës Vermicë-Suharekë, komunikacioni ka qenë normal, është zhvilluar pa asnjë pengesë gjë që nuk ka qenë rast ndoshta në vendet në rajon. Dhe them me bindje të plotë që Kosova përkundër vështirësive, përkundër trashësisë së borës, përkundër acarit që ka mbretëruar është përballur me situatën më mirë se me vendet në rajon. Besoj se i keni informatat zyrtare ju, ashtu si i kam edhe unë.

Vlen të përmendet se shumica e rrugëve drejt vendkalimeve kufitare, kanë qenë të kalueshme. Përrjashtim ka bërë pika kufitare Pejë-Kullë-Rozhajë dhe kjo jo me fajin e Kosovës por për shkak se pjesa e Malit të Zi ka qenë e pakalueshme, dhe kemi qenë të detyruar të mos ta kemi të lirë komunikacioni.

Vështirësi ka në zona kodrinore-malore dhe po i përmend akset rrugore: Pejë-Kuqishtë, Qafë-Morinë, Qaf –Prush. Aksi i rrugës Prizren-Prevallë dhe pjesa e rrugës që çon drejt qendrës të skijimit në Brezovicë. Po ashtu edhe Shala e Bajgorës, ku dje kam qenë drejtpërdrejt vet, pra në vend të ngjarjes dhe tash e kam informatën se në të dy drejtimet - Shala e Bajgorës është e qarkullueshme.

Po ashtu, edhe në Brezovicë, ortiqet që kanë ndodhur tani po hiqen nga rruga dhe rruga do të jetë e kalueshme deri në fund të ditës. Prevalla tashmë po qarkullohet dhe deri tash mund të themi se të gjitha rrugët magjistrale dhe rajonale të Kosovës janë të qarkullueshme, në segmente të caktuara me vështirësi, për çka duhet të kemi kujdes në komunikacion dhe t'i kemi pajisje të duhura dimërore.

Në këtë rast dua të bëjë edhe një herë thirrje, ashtu siç e kemi bërë edhe në të kaluarën, gjatë këtyre ditëve se të gjitha mekanizmat e Qeverisë janë në dispozicion, i gjithë potenciali që është përdorur deri tash ka qenë i mjaftueshëm për mirëmbajtjen e rrugëve magjistrale dhe rajonale. E kemi përkrahjen e plotë të gjitha mekanizmave të tjerë në rast nevojë për ta deblokuar ndonjë rast nëse ka bllokada rruge dhe, natyrisht se po i përcjellim me interesim të shtuar të gjitha zhvillimet e mëtutjeshme kur do të kemi edhe fillimin e shkrirjes së borës.

Një punë të madhe e ka bërë Forca e Sigurisë në ndihmesë autoriteteve komunale. Ne si Ministri kemi arritur që të ndihmojmë edhe autoritetet komunale në disa raste, madje kemi ndihmuar edhe në hapjen e rrugës deri në Bajram Curr, për çka konsideroj se jemi përballur suksesshëm në situatën e krijuar në Kosovë dhe uroj që të kemi në solidaritet

të lartë të të gjithëve dhe nuk dëshiroj që rasti Restelica të mos keqpërdoret në një kuptim tjetër politik apo për diçka tjetër.

Unë garantoj se ne kemi marrë të gjitha masat e nevojshme dhe kush ka qenë atje, unë besoj se kanë qenë shumica prej juve, e ka parë gjendjen reale dhe e dinë se çfarë është bërë dhe si është bërë atje. Prandaj, pas betejës, e dimë se dalin shumë heronj, por nuk është mirë t'i keqpërdorim. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Replikë, zonja Bajrami!

HYKMETE BAJRAMI: Ju faleminderit, kryesues!

I falënderoj të dy ministrat që morën mundin me më bindur se ajo që e thash nuk është e drejtë.

Unë e kam para vetit një dokument që Qeveria ia ka dërguar Kuvendit për informim – prej 8 faqe, ku në 58 projekte shkurtohen mjetet.

Edhe ministri Mujota e dinë shumë mirë se kjo është bërë me qëllimin që 11 milionë që i ka krijuar obligime Ministria e tij në vitin e kaluar pa i zotuar mjetet, iu kanë shkurtuar projekteve të cilat ende nuk kanë filluar. Dhe kjo nuk është e drejtë.

Sikur të kishin qenë në fazën e amendamentimit të buxhetit, këtu na kishin dal diku 100 amendamente. Pa kurrfarë ndryshimi, pa votën e Kuvendit, me i bë këto ndryshime, nuk është e ligjshme.

Neni 7 paragrafi 2... Neni 7 duhet të shikohet në tërësi. Ai i ka disa paragrafë, nuk e ka vetëm paragrafin 2. Kështu që për me e implementuar paragrafin 2 duhet me e shikuar edhe paragrafin 1 ku thotë: “nga bilancet e pashpenzuara”. E potencoj: “nga bilancet e pashpenzuara”!

Unaza e Prishtinës, nuk ka filluar ende. Rruga Pejë-Prishtinë, është në ndërtim e sipër, nuk ka asnjë të drejtë që t'i merren mjetet, t'i merren 1 milionë rrugës Pejë-Prishtinë dhe ato mjete të dërgohen nëpër projekte të cilat Ministria e Infrastrukturës i ka përfunduar dhe veç ka me i paguar faturat.

Ato fatura nuk ju kanë prezantuar Kuvendit si të tilla. Do të thotë janë bërë investimet pa i zotuar mjetet.

Kjo është shkelje e ligjit edhe mos të mundohen, se nuk munden me më bind. Mua më bindin vetëm këto fakte: 58 projekte të shkurtuara, buxhet i shkurtuar. Kjo është shkelje e Ligjit, kështu që mos u mundoni se nuk ka kush që më bindë se nuk është kështu.

Mundohuni t'i bindni qytetarët. Abuzoni me ligjin deri kur t'ju vazhdon, por kjo nuk është në rregull. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Zoti Ministri i Financave, e do fjalën, a po? Po, ministri i Financave, zoti Hamza e ka fjalën, për kundër-replikë, a?

MINISTRI BEDRI HAMZA: Nuk e kemi na qëllimin me i bindur, bile të paktën nuk do të harxhojmë energji me i bindur ata që nuk donë as me e lexuar ligjin mirë edhe nuk është qëllim ynë për atë.

Qëllimi ynë është me e respektuar ligjin, me e ekzekutuar ligjin ashtu qysh e ka aprovuar ky Kuvend.

Të gjitha veprimet janë bërë në harmoni me Ligjin dhe nenin 7, paragrafi 2. Prandaj, organizatat buxhetore e kanë shfrytëzuar këtë të drejtë, duke u bazuar në këtë nen të këtij ligji. Gjithçka është vepruar me procedurë dhe është në harmoni të plotë me Ligjin e buxhetit. Ndërsa, ata që nuk donë me lexuar mirë, ata që donë keqinterpretuar, është çështje e tyre dhe është e drejtë e tyre të veprojnë ashtu. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti Mujota!

LIBURN ALIU (*Ndërhyn*): Ju faleminderit!
Unë kështu e kam, çështja ime apo pjesa ime e replikës lidhet me...

KRYESUESI: Po ty, nuk ta kam dhënë fjalën, jo!

LIBURN ALIU: ...fjalën e zotit Ministër “heronj pas beteje” e “keqpërdorim politik” kur bëhet fjalë për Restelicën. Nuk po di kah e morët atë fjalë, a po kupton? Pra, këto fjalë “hero pas beteje”, “keqpërdorim politik” e këto gjëra...

Mua, me sa më duket, kur folëm për Restelicën e përmenda si shembull të mirë të mobilizimit të qytetar. Fola edhe për FKS-në, a po dini.

Unë mendoj që ndoshta problemi është te ju, ndërsa për sa i përket rrugëve, rrugët rajonale dhe magjistrale nuk janë ato të cilat i bllokojnë qytetarët.

Unë këtu e përmenda shumë qartë. Ka vendbanime të cilat janë të izoluara dhe të bllokuara, janë zonat më të thella. Për këtë ka nevojë për një mobilizim qytetarë dhe mobilizimi qytetar i bënë shumë mirë shoqërisë. Duhet të organizohet ajo nga Qeveria, e nga pushtetet komunale.

Vendet tjera i shfrytëzojnë këto raste shumë mirë për me e bërë mobilizimin qytetar, sepse është shërim për shoqërinë. Ndërsa, këto çështjet e heronjve, e keqpërdorimeve politike. Po këqyrni keqpërdorimet politike që po i bënë Serbia në krah të Restelicës, me ato merrni, a më kuptoni.

Besoj se e dëgjuat atë çka e thash unë dhe referojuni asaj që thash.

KRYESUESI: Ju faleminderit! Zoti Mujota e keni fjalën.

MINISTRI FEHMI MUJOTA: Ju faleminderit!

Tani më duhen për dy çështje të përgjigjem njëkohësisht.

Tek rasti që foli zotëri Liburn Aliu tani, besoj se e konstatoi të njëjtën gjë që e thash edhe unë. Dhe Serbia ose kushdo tjetër që është i interesuar në kuptim tjetër politik, përgjigjen e ka marrë nga Qeveria e Republikës së Kosovës, nga angazhimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës, të gjitha institucioneve të vendit, të qytetarëve të Republikës së Kosovës, e posaçërisht të banorëve të fshatit Restelicë që e kanë pasur një tragjedi të madhe.

Prandaj nuk kisha dëshiruar që t'i rikthehem kësaj çështjeje. Ndërsa çështjen duhet ta shohim korrekt dhe drejtë se sa është angazhuar Qeveria dhe resurset tona përgjithësisht për mirëmbajtje dhe tejkalimin e gjendjes së krijuar në Kosovë pas reshjeve të mëdha të borës.

Zonja deputete, Bajrami! Ju jeni anëtare e Komisionit për Buxhet dhe Financa. Unë jam shumë i bindur se ju, nga profesioni i juaj, dhe nga përgjegjësia e juaj që e keni në këtë Komision, i keni pasur projektet të prezantuara një për një.

Vetëm një gjë nuk e besoj, se ju po kërkonit që ministri Mujota të mos i vazhdojë projektet që kanë filluar para 3 viteve dhe mos t'i përmbyllë ato. Pra këtë, nuk besoj që ju po kërkonit, dhe kjo nuk të ndodhë. Pra, do të kryhen të gjitha projektet e filluara. Sikur që nuk besoj se ju po kërkonit që të mos ketë projekte të reja. Do të ketë projekte të reja dhe të gjitha ato që figurojnë, do të mbarohen në afatin e parapara ligjore.

HYKMETE BAJRAMI: Ministër ju a nuk e keni ditur që ka projekte në vazhdim, para dy muajve a? A nuk e keni ditë, a?! Po më duket se tash të ka ra ndër mend se ke projekte në vazhdim.

KRYESUESI: Ju faleminderit! Tani do të bëjmë një pauzë prej 15 minutsh.

(Vijon pauza)

(Pas pauze, seanca vazhdon punën)

KRYESUESI: Të nderuar deputetë,
Vazhdojmë me pikën e dytë të rendit të ditës, që është:

2. Koha për pyetje parlamentare.

Në pajtim me nenin 45, pika 1 të Rregullores së Kuvendit, koha për pyetje të deputetëve për Qeverinë është e kufizuar në 60 minuta.

Deputeti për një mbledhje mund të parashtrojë më së shumti dy pyetje.

Pyetja e parë është e deputetit Daut Haradinaj. Nuk është këtu.

Pyetja e dytë është e deputetes Alma Lama, për kryeministrin Hashim Thaçi. Nuk është Alma këtu.

Pyetja e tretë është e deputetes Valbona Dibra. Pyetje për ministrin Stavileci. Ministri nuk është këtu. A doni, ta bëni pyetjen? Atëherë, kur të kthehet.

Pyetja e katërt, deputetja Time Kadrijaj. Pyetje për ministrin Ferid Agani. Nuk është as ministri, as deputetja këtu.

Deputeti, Visar Ymeri, pyetje për kryeministrin Hashim Thaçi. A dëshironi ta bëni pyetjen, me qenë se nuk qenka kryeministri këtu. A dëshironi? Atëherë, fjalën e ka zoti Ymeri.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryesues!

Me qenë se kryeministri nuk qenka këtu, e pyetja i drejtohet atij natyrisht, unë vetëm desha me e treguar çështjen për çka ka të bëjë pyetja, dhe natyrisht e pres përgjigjen nga kryeministri.

Kjo pyetje e imja ka të bëjë me dy takime që i ka pasur kryeministri me presidentin apo kryetarin e Serbisë Boris Tadiqin. Njërin takim në Selanik, në cilësinë e kryetarit të Partisë Demokratike të Kosovës atëherë në vitin 2006 si dhe një takim tjetër në Nju Jork, në Selinë e OKB-së në vitin 2008 në cilësinë e kryeministrit të Kosovës.

Pra pyetja ime kishte të bëjë me këtë, mirëpo siç po shihet kryeministri nuk ka ardhur këtu dhe nuk mund të përgjigjet, e unë do ta shtroj pyetjen prapë në seancën e ardhshme.

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Rexhep Selimi, pyetje për kryeministrin Hashim Thaçi. Zoti Selimi!

REXHEP SELIMI: Faleminderit, zoti kryesues!

Po ashtu edhe pyetja ime ka të bëjë për të njëjtën temë, por pyetja ime, me që kryeministri nuk është këtu, e pyetje ka të bëjë me atë se çka ka përfitua Kosova prej takimeve me Tadiqin. Atëherë po e ruaj të drejtën e rezervuar me pyet në seancën e ardhshme se vërtet, mendoj që duhet të përgjigjet kryeministri.

KRYESUESI: Faleminderit!

Deputeti Glauk Konjufca, pyetje për kryeministrin Hashim Thaçi. Zoti Konjufca a dëshironi ta merrni fjalën? Ju lutem, zotit Konjufca, ia mundësoni ta marrë fjalën. Regjia! E keni kartelën Glauk? Tash është në rregull.

GLAUK KONJUFCA: Atëherë, pyetja ime për kryeministrin po ashtu ka të bëjë me dy takimet e tij të realizuar me Boris Tadiqin dhe mua më intereson se cila anë në këtë rast e ka pas iniciativën për me u takuar dhe kush ka qenë ndërmjetësuesi.

Por, me qenë se kryeministri nuk paska ardhur, atëherë e presim përgjigjen nga ai herëve të tjera.

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti, Liburn Aliu, pyetje për kryeministrin Hashim Thaçi. Zoti Aliu.

LIBURN ALIU: Njëjtë, edhe për mua. Pyetja ime ka të bëjë për kryeministrin Hashim Thaçin dhe ka të bëjë me takimet e tij me presidentin e Serbisë Boris Tadiq, duke u bazuar në burimet e Vikeliksit. Mirëpo me qenë se nuk është kryeministri këtu, po e rezervoj pyetjen për herën tjetër.

KRYESUESI: Deputetja Albulena Haxhiu, pyetje për kryeministrin Hashim Thaçi. A e dëshironi fjalën? Deputetes Haxhiu, fjalën.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit, kryesues!

Çështja është e njëjtë, pra ka të bëjë me dy takimet e kryeministrit Thaçi me Boris Tadiqin. Njëri takim në vitin 2006 në Selanik dhe tjetri në Selinë e OKB-së në vitin 2008.

Pyetja për kryeministrin është se kush tjetër ka marrë pjesë në ato takime dhe se për çfarë kanë biseduar? Çfarë i ka thënë Tadiqi Thaçit dhe çka Thaçi Tadiqit? Pra presim përgjigje herën tjetër.

KRYESUESI: Faleminderit!

Deputeti Afrim Kasolli, pyetje për kryeministrin Hashim Thaçi. Zoti Kasolli! Nuk është. Jo, këtu qenka dhe, më falni! Fjalën e ka zoti Kasolli.

AFRIM KASOLLI: Faleminderit kryesues!

Edhe pyetja ime ka të bëjë lidhur me këto takime që u referuan më herët, ndërmjet kryeministrit Thaçi dhe presidentit të Serbisë Boris Tadiq.

Pyetja ime ka të bëjë se - a janë raportuar diku këto takime, nëse po ku janë raportuar dhe kush ka qenë raportuesi. Por me që kryeministri nuk ndodhet këtu, presim përgjigje nga kryeministri në seancën tjetër. Faleminderit!

KRYESUESI: Dauti nuk është kthyer akoma. Domethënë nuk kemi nevojë t'i përsërisim. As Alma nuk është.

Atëherë konstatoj që nuk ka pyetje të tjera. Ata që kanë munguar kuptohet i përsërisin ato pyetje në seancën e ardhshme.

Pyetjet e deputetëve që nuk marrin përgjigje në dy seancat plenare do të publikohen në revistën e Kuvendit, neni 45 paragrafi 11 i Rregullores së Kuvendit.

Kalojmë në pikën e tretë të rendit të ditës, që është:

3. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 2 shkurt 2012.

Të nderuar kolegë dhe kolege,
Pyes nëse keni vërejtje në këtë procesverbal? Nuk ka vërejtje.

Atëherë, konstatoj që Kuvendi e miratoi Procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 2 shkurt 2012.

Në sall janë prezentë 65 deputetë.

Vazhdojmë me pikën e katërt të rendit të ditës, që është:

4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për tatim mbi vlerën e shtuar.

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, komisioni funksional e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime për shqyrtim në parim.

Ftoj ministrin e Financave, zoti Bedri Hamza, që para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë dhe arsyetojë Projektligjin.

MINISTRI BEDRI HAMZA: I nderuari nënkryetar i Kuvendit,

Të nderuar zëvendëskryeministra,

Ministra,

Deputetë të nderuar,

Kjo iniciativë e Ministrisë së Financave është pjesë e programit legjislativ të Qeverisë së Republikës së Kosovës për vitin 2012 në kuadër të strategjisë së reformave që i ka ndërmarrë Qeveria për përkrahjen e bizneseve, zhvillimin e mëtejshëm të sistemit të arsimit, uljes së kostos së shërbimeve sociale dhe zhvillimit të mediave elektronike dhe të shkruara në Kosovës.

Ky Projektligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për tatimin në vlerën e shtuar është edhe në kuadër të objektivave tona të përhershme për përafrimin dhe harmonizimin e legjislacionit tonë me atë të Komunitetit Evropian.

Qëllimi i ndryshim-plotësimit të Ligjit për tatim në vlerën e shtuar është rregullimi i situatave të veçanta të cilat me Ligjin për tatim në vlerën e shtuar numër 03/L-146 nuk janë përmbushur në tërësi.

Këto ndryshime të cilat po i paraqesim sot përveç orientimit të përgjithshëm të strategjisë së Qeverisë për mbështetjen e bizneseve dhe krijimin e kushteve sa më të volitshme për përshtetimin e tyre është po ashtu edhe në kuadër të synimeve tona për përshtatjen me direktivat e BE-së për TVSH-ën.

Në këtë drejtim, me qëllim të avancimit të vazhdueshëm të bazës ligjore të tatimit në vlerën e shtuar, me këtë ndryshim plotësim të Ligjit për tatimin në vlerën e shtuar kemi përcaktuar:

- vendin e furnizimit të mallrave dhe persona të tatueshëm,
- pastaj vendin e furnizimit të shërbimit,
- transportin ndërkombëtar të pasagjerëve dhe transportin e mallrave të tyre shoqëruese,
- rregullimet për zbritjen e TVSH-së së zbritshme dhe mallrat nën aranzhimet e posaçme doganore.

Po ashtu, me këtë projektligj kemi liruar nga TVSH-ja:

- mediat elektronike dhe të shtypura për furnizimet e shërbimeve dhe mallrave të importuara vetëm për qëllimet e tyre,
- gazetatat, revistat dhe periodiket, universitetet private, shërbimet spitalore dhe kujdesin mjekësor.

Të nderuar deputetë,

Me qëllim të avancimit të mëtejshëm të legjislacionit për tatim në vlerën e shtuar, pastaj vënien e tij në funksion të plotë të përkrahësve të bizneseve, zhvillimit të arsimit profesional dhe uljes së kostos për mirëqenie dhe shërbime sociale, kërkoj që ta aprovoni këtë projektligj. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Tani, të nderuar deputetë, pas prezantimit të Projektligjit e hapim debatin për diskutim në parim. Radhën e ka kryetarja e komisionit funksional për Buxhet dhe Financa, deputetja Hadergjona.

SAFETE HADERGJONAJ: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar anëtarë të kabinetit qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Qeveria gjatë këtij viti na i ka afruar disa projektligje të cilat kanë të bëjnë në përmirësimin e politikës fiskale dhe në përgjithësi me përafrimin e këtyre ligjeve të cilat kanë ekzistuar me legjislacionin e Bashkësisë Evropiane.

Të gjitha këto projektligje janë duke u shqyrtuar në Komisionin për buxhet dhe financa.

Në këtë grup të këtyre projektligjeve hyn edhe ky projektligj për plotësim-ndryshimin e Ligjit për tatimin në vlerën e shtuar të cilin projektligj në shqyrtim të parë e ka pasur Komisioni për buxhet dhe financa.

Ne në Komision e kemi shqyrtuar këtë projektligj në mbledhjen e datës 1 shkurt të këtij viti dhe unanimisht e kemi përkrahur që të miratohet në lexim të parë në Kuvend.

Me këtë projektligj janë rregulluar disa çështje të cilat Ligjin mbi tatimin në vlerën e shtuar e përafrojnë me legjislacionin e Bashkësisë Evropiane dhe me këtë plotësim-ndryshim është rregulluar më mirë përcaktimi i vendit të furnizimit të mallrave për persona të tatueshëm, vendi i furnizimit të shërbimit, transporti ndërkombëtar i udhëtarëve dhe transporti i mallrave shoqëruese të tyre, dhe po ashtu me këtë projektligj janë liruar nga tatimi mbi vlerën e shtuar shërbimet spitalore dhe kujdesi mjekësor gjë që ndikon në jetën e çdo qytetari. Gjithashtu nga tatimi janë liruar edhe fakultetet private, mediat elektronike dhe të shkruara, që Komisioni e ka vlerësuar si pozitive këtë ulje të TVSH-së me bindjen se do të kontribuojë në krijimin e kushteve për afarizëm më të suksesshëm të këtyre institucioneve.

Prandaj, në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa ju ftoj deputetë të nderuar, ta miratojmë në lexim të parë këtë projektligj, kurse vërejtjet dhe rekomandimet tuaja do t'i shqyrtojmë me kujdes gjatë punës së mëtutjeshme në Komision, gjatë fazës së amendamentimit të Projektligjit.

Zoti kryesues,

Nëse më lejohet i kisha thënë edhe dy fjalë në emër të Grupit Parlamentar në mënyrë që të mos marrë fjalën përsëri.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, po ashtu e ka shqyrtuar Ligjin mbi tatimin mbi vlerën e shtuar dhe e ka përkrahur rekomandimin e Komisionit që ky projektligj të miratohet në lexim të parë në Kuvend dhe të gjitha vërejtjet të cilat i ka në lidhje me nenet të cilat janë në këtë projektligj do t'i paraqesim në Komisionin për buxhet dhe financa të cilat presin të shqyrtohen. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Ky ishte edhe për prezantim në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës. Tani, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, zonja Hykmete Bajrami, e ka fjalën.

HYKMETE BAJRAMI: Faleminderit, kryesues!

Na është thënë se arsyeja kryesore e ndryshimit të këtij ligji, dhe na u tha tani - është përafrimi me legjislacionin e Bashkësisë Evropiane.

Por si mund të bindemi ne deputetët e Kuvendit të Kosovës për një gjë të tillë, jo të paktën ata që e kanë lexuar këtë ligj dhe dokumentacionin përcjellës.

Nëse ky ligj është bërë për ta përafuar ligjin me legjislacionin e BE-së, unë po ju shpalos disa fakte që na bindin se kjo nuk qëndron.

Së pari. Ministria e Integriteteve Evropiane e jep një deklaratë pa lexuar fare projektligjin. Ku thotë se ky ligj nuk cenon parimet themelore të BE-së dhe mendon se Ministria ka bërë mirë që e ka ulë pragun e bizneseve për TVSH nga 50.000 në 30.000.

Ulja e pragut të TVSH-së nuk është fare pjesë e këtij projektligji, por si duket sekretari i Ministrisë së Integritimit Evropian e ka nënshkruar deklaratën, që i ka shkruar dikush tjetër, pasi që edhe mbietimi i tij aty ku është vënë nënshkrimi është i shkruar gabimisht. Këto janë gjëra krejt teknike por sidoqoftë tregojnë seriozitetin e kësaj Qeverie në punë.

Q'është e vërteta, Qeveria pati premtuar verën e kaluar se do ta ulë pragun e TVSH-së nga 50.000 në 30.000 dhe po ashtu premtoi se do të bëhet përshkallëzimi i TVSH-së nga 7% deri 17%.

Këto premtime nuk janë pjesë e Projektligjit dhe ne i themi Qeverisë se nuk po i mbanë premtimet.

Ne si LDK, e kemi edhe një vërejtje tjetër. Kjo Qeveri shpesh po i ndryshon ligjet vetëm sa për të thënë se po bënë diçka, pa prekë shumë në përmbajtjen e tyre për të mirë të bizneseve dhe qytetarëve të vendit.

Premtimet për pakon e re fiskale, edhe pse ishin shumë të mirëseardhura për qytetarët dhe bizneset, po mbesin vetëm premtime. Fondi Monetar Ndërkombëtarë e bindi Qeverinë se ajo nuk e ka kapacitetin e duhur për të bërë ndërrimet e premtuara në politikën fiskale.

Tani Qeveria po bënë ndërrime jo relevante, por kjo Qeveri duhet ta ketë një gjë parasysh, se në një vend ku politikat fiskale ndërrojnë në baza mujore, investitorët seriozë hezitojnë të investojnë.

Ne e mirëpresim vendimin e Qeverisë për lirim të mediave dhe të universiteteve nga TVSH-ja, por Ministria e Financave ende nuk e ka dhënë një përgjigje si do ta adresojë lirim të mediave nga TVSH-ja kur ato furnizohen nga kompanitë vendore.

Ne kërkojmë nga Qeveria që t'i mbajë premtimet, ta rrisë kapacitetin e administratës tatimore dhe doganave, të zvogëlojë evazionin fiskal i cili llogaritet të jetë mbi 300 milionë euro, dhe politikat fiskale t'i ndërroj vetëm atëherë kur të bindet se do të kenë me të vërtetë efekte pozitive. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar Vetëvendosje, deputetja Fetoshi, është paraqitur.

ALBANA FETOSHI: Faleminderit, kryesues!

Ligji për TVSH-në po ndryshohet bukur shpesh dhe atë me ndryshime shumë të vogla. Kjo nuk do të ishte mirë për tatimpaguesit sepse kjo po krijon konfuzion tek ata pasi që ai asnjëherë nuk mund ta dijë se cili është versioni përfundimtarë që ajo konceptohet me ligjin.

Te vërejtjet, te neni 2.5 definohet apo ridefinohet bordi i pavarur, rishqyrtimi dhe roli i tij sipas këtij draft-ligji reduktohet dukshëm, sepse sipas këtij projektligji bordi vetëm i pranon ankesat por jo edhe t'i shqyrtoj ato.

Nëse bordi i vetëm i pranon ankesat e tatimpaguesve, atëherë kush do të merret me shqyrtimin e tyre?

Te neni 11, që merret me ndryshimin e nenit 20 të Ligjit për TVSH-në, në vend se të definohet vendi i furnizimit për shërbime Projektligji merret me definimin e personit të tatueshëm. Si rrjedhojë kjo pjesë ka nevojë për modifikime.

Po ashtu vërehet se një pjesë e madhe e ndryshimeve të propozuara janë çështje periferike dhe të pakuptimta. Për shembull çfarë kuptimi ka që në ligjin tonë për TVSH-ën të caktohen obligimet për ushqime që ofrohen në kuvertat e anijes ose trenit. Cila është ajo anija, apo cili është ai tren që kalon nëpër Kosovë dhe ofron ushqime për të cila është dashtë të ngarkohet TVSH-ja?

Një situatë e njëjtë është nenet që trajtojnë juti fri-shops ku mallrat lirohen nga TVSH-ja dhe ku thuhet se udhëtarët duhet ta kenë biletën për portin detar ndërkombëtar.

A mund të na e thoni vetëm një rast, ku kjo dispozitë do të gjente aplikim në Kosovë?

Si përfundim, me përjashtim të nenit që liron furnizimet për mediat nga TVSH-ja dhe universitetet, ky projektligj nuk sjell diçka tjetër të re që do të ishte me peshë për tatimpaguesit.

Prandaj, duke i marrë parasysh edhe këto vërejtje që i parashtruam tani dhe këto ndryshime, besoj se do të merren parasysh edhe nga puna që do të bëjmë në komisionin funksional, Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje e mbështetë në parim këtë projektligj. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Grupi Parlamentar i AAK-së, deputeti Neziraj.

XHEVDET NEZIRAJ: Faleminderit, i nderuari zoti nënkryetar!

Kryeministër,

Ministra,

Dhe kolegë deputetë,

Edhe ky projektligj përcakton nga ekspozeu i ministrit mënyrën e përcaktimit për furnizim të mallrave për persona të caktuar, vendin e furnizimit të shërbimit të transportit ndërkombëtar, të pasagjerëve dhe transportit të mallrave, rregullimin dhe zbritjen e TVSH-së së zbritshëm, gjithashtu edhe të mediave elektronike.

Mirëpo, ne si Grup i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës kemi pritur që në këtë pako fiskale, mos tash por bile në të ardhmen, të bëhet edhe shkallëzimi i TVSH-së, e sidomos ulja e TVSH-së në disa produkte që godasin një shtresë që ka nevojë mbrojtjeje.

Gjithashtu presim që në të ardhmen të bëhen edhe lirime të mjeteve të cilat çojnë kah zhvillimi i biznesit dhe një lirim sa më të madh për hapjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme me qëllim që prodhimi të jetë në Kosovë prodhuesor.

Prandaj, presim që në Ligjin dhe në ndryshimin e Ligjit në të ardhmen këto gjëra të ndodhin dhe të jenë një stimulim i mirë për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme të cilat kanë të bëjnë me zvogëlimin e një numri të papunëve sidomos në Kosovë pasi që varfëria për çdo ditë është në rritje.

Unë shpresoj që shumë shpejtë kjo pako e re fiskale do të vjen prapë në këtë Kuvend, e do të vjen në Komisionin e Buxhetit dhe do të bëhen ndryshime më rrënjësore në politikën fiskale të cilat do të kishin me sjell më shumë lirime në ato gjëra të cilat e prekin popullatën dhe e prek shtresën e varfër.

Ne, si Grup Parlamentar, jo vetëm se do ta përkrahim, por do të ndihmojmë që të eliminojmë edhe disa gabime gjuhësore që janë në këtë projektligj dhe kontributin tonë do ta japim në komisionin funksional dhe komisionet e përhershme në të cilat do të kalojë Projektligji, e po ashtu edhe ndryshimet tjera që do të vijnë në të ardhmen nga politika fiskale për të mirën e qytetarëve të Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Mirë është me e mbajt mikrofonin afër kur flisni, se nuk po dëgjoheni sa duhet. Koalicioni Kosova e Re, zoti Mustafa, e ka fjalën.

MUHAMET MUSTAFA: I nderuari kryesues,

Edhe Koalicioni për Kosovën e Re e mbështet këtë ligj në procedurën e mëtejme. Ne konsiderojmë se Ligji ka bërë një avancim në përcaktimin e procedurave më të mira të arkëtimit dhe ri-mburësimit përkatësisht rikthimit të tatimit në vlerën e shtuar, ka barazuar në treg ofruesit në arsimin e lartë, privat e publik, gjë që e rregullon më mirë në treg pozitën e tyre. Gjithashtu i ka bërë edhe disa përmirësime teknike.

Ne kemi pritur sinjerisht që me pakon e re dhe me këtë ligj do të bëhet një hap më tutje në përmirësimin e mjedisit biznesor dhe në favorizimin e investitorëve dhe në këtë drejtim ngelin për tu analizuar, varësisht nga mundësitë buxhetore.

Unë mund të kuptoj se janë problemet e buxhetit ë këtë moment, mirëpo ne konsiderojmë se problemet buxhetore nuk do të duhej të ishin pengesë që të bëhet një ndryshim edhe më i theksuar i cili favorizon investimet në importin e pajisjeve dhe importin e lëndëve të para dhe inputeve tjera për prodhim.

Konkretisht, mund të jetë problem neni 2 ku si investim kapital konsiderohen vetëm pajisjet që e tejkalojnë vlerën prej 20.000 eurove. Ka biznese edhe më të vogla, fermerë por edhe biznese më të vogla, që mund të importojnë pajisje që kanë një vlerë më të vogël edhe se 20.000 euro, prandaj kjo ndoshta do të duhej të shikohej, për arsye se ndoshta për disa biznese të vogla ky prag nuk është i nevojshëm apo nuk është i përshtatshëm.

Çështja e arkëtimit të TVSH-ës në kufi me një pritje eventuale prej 6 muajve për pjesën më të madhe të pajisjeve - godit investitorët. Prandaj, kjo çështje ka ngelë për një kohë të gjatë e pazgjidhur dhe ne presim që, në mos me këtë ligj, me një pako të shpejtë që kjo çështje të zgjidhet, për arsye se të gjitha këto ndryshime që po i bëjmë ne në këtë ligj nëse

nuk e korrigjojmë arkëtimin e TVSH-ës në pajisje të mëdha të cilat mund të krijojnë vende të punës, ne do të ngelim edhe më tutje me pak investime të jashtme dhe të brendshme. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka tjerë të paraqitur në emër të grupeve parlamentare. Fjalën e ka deputeti Deshishku.

HASHIM DESHISHKU: I nderuari nënkryetar, zoti Haliti,
Të nderuar ministra,
Të nderuar kolegë deputetë e deputete,

Propozimet për ndryshimin e Ligjit për TVSH-ën kryesisht përqendrohen në definimin më të qartë, si dhe përshtatjen e disa zgjedhjeve dhe termave ligjore ndaj rrethanave të reja, që do të thotë se nuk ka shumë risi, pa marrë parasysh premtimet e bëra nga Qeveria e Kosovës për ndryshimet qenësore, përmes të cilave do të lehtësohen procedurat për deklarime dhe pagesën e TVSH-ës, si dhe krijohen rrethana më të mira për zhvillimin e bizneseve dhe forcimin e bazës së tij materiale.

Në anën tjetër, me ndryshimet e propozuara nuk kanë gjetur vend premtimet që më parë i kishte dhënë Qeveria e Kosovës, apo edhe ato që i thanë gjatë fushatës parazgjedhore partitë që tash e mbajnë pushtetin. Konkretisht, mendoj në TVSH-ën e përshkallëzuar, përkatësisht uljen e këtij tatimi për produkte ushqimore dhe mallrat strategjike dhe ngritjen për artikuj që nuk e rëndojnë shumë buxhetin familjar.

Me këtë rast po përmendi se në tërë rajonin, vetëm Kosova dhe Shqipëria e kanë normën e njëjtë të TVSH-ës për të gjithë artikujt, dhe te ne në Kosovë 16%, kurse në Shqipëri 20%.

Sa për ilustrim po përmendi se në Mal të Zi artikujt ushqimorë dhe disa produkte farmaceutike dhe pajisjet shkollore ngarkohen me TVSH 7%, kurse të tjerat 17%. Në Maqedoni TVSH-ëja është 18%, kurse për produktet ushqimore 5%. Në Kroaci aplikohet norma 22% dhe 10% për produkte. Në Serbi 18%. Në Slloveni 20% dhe 8.5% janë produktet tjera.

Po ashtu, është premtuar lehtësi fiskale përkatësisht heqje të TVSH-ës për importin e lëndës së parë dhe ambalazhet, çështje që nuk kanë gjetur vend në këto propozime të Qeverisë.

Propozoj që gjatë leximit të dytë në këtë dokument të përfshihen edhe këto propozime. Dokumenti që po e shqyrtojmë ka pak risi, përkatësisht ato vërehen në nenin 15 që ka të bëjë me nenin 27 të Ligjit përkatësisht lirimet për aktivitete të caktuara me interes publik.

Kësaj liste tash i janë shtuar edhe gazetatat e revistat dhe periodikët si dhe furnizimet e shërbimeve, për mediat elektronike dhe të shtypura.

Kam edhe disa vërejtje në disa nene, të cilat ose nuk janë të sqaruara sa duhet apo nuk japin një zgjidhje të qëndrueshme.

Pika 5 e propozimit që ka të bëjë me nenin 2 nën-paragrafi 1.43 që përkufizon bordin e pavarur për rishqyrtim. Aty thuhet se ai, citoj: “është kompetent për pranimin e ankesave sa i përket taksave të paraqitura nga tatimpaguesit deri në nëntor 2012”. Nuk e di, pse kufizohet viti 2012? Kurse mund të kemi edhe ankesa më vonë se nëntori.

Është e paqartë se pse bëhet ky afatizim, me çka është i ndërlidhur nëntori i vitit 2012. As nga ligji, as nga propozimet për ndryshimet dhe plotësimet, nuk është e qartë pse përdoret ky afat kohor. Propozoj që të hiqet pjesa e fjalisë “deri në nëntor 2012”.

Nën dy. Neni 18 pika 2, propozimi që ka të bëjë me nenin 31 të Ligjit, nën-paragrafi 2.1.3, zëvendësohet me tekst të ri, ku thuhet, citoj: “Udhëtari i cili nuk është i vendosur brenda Kosovës nënkupton udhëtarin ku adresa e tij e përkohshme ose vendbanimi i tij i zakonshëm nuk është vendosur brenda Kosovës”. Me këtë rast, adresë e përhershme ose rezidencë e zakonshme nënkupton vendin e regjistruar në pasaportë, letërnjoftim ose dokument tjetër.

Krejt ky tekst duhet të zhvendoset në fillim të ligjit, përkatësisht në nenin 2 që ka të bëjë me përkufizimet, ndërkaq të mbetet pjesa e tekstit që rregullon mënyrën për ta dëshmuar eksportin.

Pika 3 e këtij neni, që ndërlidhet me nenin 31 pika 2.d) e Ligjit që ka të bëjë me rimbursimin e TVSH-ës. Kjo çështje definohet me një akt ligjor që duhet ta nxjerrë Ministria e Financave. Aty duhet të caktohet edhe data prej kur fillon lirimi nga obligimi tatimor sepse nuk përmendet afati se kur duhet ta bëjë këtë ministri. Madje kjo nuk është e rregulluar as në ligj, por në parim do ta përkrah këtë ndryshim të Projektligjit të TVSH-ës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Visar Ymeri, e ka fjalën!

VISAR YMERI: Faleminderit, kryesues!

Kur diskutojmë për plotësim-ndryshimet e ligjeve që na vijnë në Kuvend, natyrisht unë konsideroj se janë dy gjëra shumë të rëndësishme. Pra, në njërën anë janë ato plotësime-ndryshime që i bën Ligji, sikur në rastin konkret, çështjet të cilat i ndryshon e plotëson dhe deri në ç’masë këto ndryshime dhe plotësime të Ligjit e bëjnë Ligjin më të mirë.

Por, unë mendoj se një çështje shumë e rëndësishme në këso raste, e madje edhe më e rëndësishme se kjo, janë edhe ato që nuk i përmend ligji. Pra, ato të cilat nuk mëtojnë të ndryshohen nga Qeveria me plotësim-ndryshimin e Ligjit.

U përmend këtu edhe nga zoti Deshishku, pra edhe për premtimet elektorale që i ka pasur kjo Qeveri por edhe një domosdoshmëri që e ka Kosova në përshkallëzimin e tatimit të vlerës së shtuar, pra që të mos i konsiderojmë të gjithë artikujt të cilët shiten në Kosovë

dhe të cilët domosdo realizojnë vlerë të shtuar të mos i kategorizojmë në të njëjtën kategori.

Pra, natyrisht se ka shumë dallim në mes artikujve të cilët kanë rëndësi jetike dhe bazike për mirëqenien e shoqërisë, për ushqimin e shoqërisë, për veshmbathjen e shoqërisë, e të tjera dhe në anën tjetër të atyre artikujve të cilët mund të klasifikohen si luks, pra që nuk janë të domosdoshme për jetë, por gjithsesi të gjenden në tregun e Kosovës për ata që kanë dëshirë t'i blejnë dhe natyrisht për ata që kanë mundësi financiare t'i blejnë. Ndërkohë, që këtu në Kosovë domethënë e kemi tatimin në vlerë të shtuar të sheshtë për të gjithë, nuk dallon as tatimi në vlerë të shtuar për qumështin e as për uiskin apo verën e shtrenjtë, gjë që është e padrejtë dhe e shkakton ose thellon edhe më tutje pabarazinë në shoqërinë tonë në kohën kur ne kemi nevojë për më shumë solidaritet dhe barazi, të institucionalizuar përmes ligjeve dhe përmes praktikave ekonomike dhe sociale.

Tatimi në vlerë të shtuar i sheshtë siç është këtu në Kosovë, natyrisht se e kushtëzon një lloj thjeshtësie të tepruar dhe dobësim të shtetit.

Pra, shteti i cili i ka të gjitha tatimet, të them ashtu, të sheshta dhe i cili nuk ka kurrfarë kategorizime në politikat e tyre për sektorë të ndryshëm edhe artikuj të ndryshëm, atëherë është një shtet i cili doemos i kushtëzohet thjeshtësia. Po flas këtu për aparatin shtetëror në përgjithësi dhe kur i kushtëzohet thjeshtësia atëherë natyrisht se nuk ka hapësirë e madje as domosdoshmëri për t'i ndërtuar kapacitetet shtetërore dhe në fund përfundojnë pastaj me një shtet të dobët i cili nuk ka kapacitete.

Pra, shumë herë dhe shpesh këtu na thuhet për çështje të ndryshme në Kosovë se shteti i Kosovës nuk i ka kapacitetet e nevojshme për ta administruar një çështje apo një tjetër, ndërkohë që vetë me praktikën tona dhe me ligjet tona ne në fakt po e pamundësojmë forcimin e shtetit, ngritjen dhe profesionalizimin e aparatit shtetëror për t'i administruar çështjet dhe këtë administrim apo këtë pamundësim të ngritjes së këtyre kapaciteteve po e bëjmë duke e thjeshtësuar jashtëzakonisht shumë praktikën institucionale siç thjeshtësohet me tatimet e sheshta, me praktika dhe procedura të administratës tatimore në këtë rast, po edhe të doganave.

Një çështje tjetër që po ashtu do të ngritët këtu, e që ka të bëjë me temën të cilën po e diskutojmë sot është edhe mbledhja e tatimit në vlerë të shtuar, i cili në shumicën e rasteve në Kosovë mblidhet në kufi, gjë që nuk ishte dashur të ndodhë për shkak se kjo e thjeshtëson po në disa raste edhe e dëmton biznesin. Këtu, tatimi në vlerë të shtuar në të gjitha vendet është tatim i cili mblidhet për së brendshmi dhe duhet të kthehet e të bëhet edhe tatim i brendshëm për shkak se shteti në fund të fundit duhet të mbahet nga tatimet të cilat mblidhen brenda territorit dhe tatimet lartësia e të cilave shkon konform zhvillimit ekonomik e jo të përcaktohet nga të hyrat e mallrave përmes importit, për shkak se kjo në njërin anë e reflekton dobësinë e ekonomisë së vendit dhe në anën tjetër e vendos shtetin para një rreziku goxha të madh se me rënien e importit natyrisht se bien edhe tatimet dhe kështu, në njëfarë mënyre buxheti ynë varet nga mallrat që i importojmë nga jashtë dhe në njëfarë mënyre ne obligohemi të importojmë më shumë për ta mbajtur buxhetin gjallë.

Pra, këto ishin ato intervenimet e mia të cilat nuk janë intervenime drejtpërdrejt në ligj, por vetëm desha t'i ngre këto çështje për shkak se janë çështje për të cilat ka folur shumë opinionioni publik në Kosovës, veçanërisht prodhuesit e Kosovës për pabarazinë dhe padrejtësinë që iu shkaktohet edhe përmes TVSH-ës e që nuk po shoh se po ndryshon me këtë ligj.

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka tjerë të paraqitur. Zoti Hamza, a dëshironi të sqaroni pak lidhur me këtë? Zoti Hamza e ka fjalën!

MINISTRI BEDRI HAMZA: Faleminderit, zoti nënkryetar!

I falënderoj të gjithë deputetët për kontributin e tyre dhe dëshiroj t'i jap disa sqarime.

Sa i përket normave tatimore, është vlerësim edhe i raporteve të institucioneve financiare ndërkombëtare se Kosova i ka normat më të ulëta. Tatimi në fitim të korporatave është 10%. Tatimi në fitim të ardhurave individuale fillon nga 0, 4, 8 dhe përfundon me shkallën maksimale 10%. TVSH-ëja është 16%.

Ne vetëm në muajt e fundit, kemi pas shumë veprime që shkojnë në favor të biznesit, sidomos të zhvillimit të sektorit privat. Ne jemi koncentruar që sektori privat të jetë bartës i zhvillimit dhe rritjes ekonomike dhe dëshiroj të ua përkujtoj vetëm disa masa që janë marrë muajve të fundit në favor të biznesit:

- Janë ulur normat e kamatave, të cilat i aplikon Administrata Tatimore për vonesat në rastin e pagesës së tatimeve për 3 pikë përqindjesh.
- Është ndërruar momenti i pagesës së akcizës në cigare ku në të kaluarën është bë pagesa në momentin e tërheqjes së banderollave ndërsa tash pagesa bëhet në momentin e arritjes së mallit në kufi.
- Është bërë shkurtimi i dokumenteve të cilët kanë qenë të nevojshëm për importimin dhe eksportimin e mallrave ku nga 9 dokumente në doganë janë thjeshtësuar dhe janë ardhur në 3 dokumente.
- Është bërë zvogëlimi i kundërvajtjeve të cilat i ka aplikuar Dogana në të kaluarën nga 5.000 në 500 euro.

Dhe, u përmend edhe çështja e Bordit për rishqyrtimin e ankesave. Është në procedurë jo vetëm Ligji dhe plotësim-ndryshimi i Ligjit për TVSH-ën por janë edhe një numër i ligjeve tjera që e trajtojnë edhe Bordin e pavarur për shqyrtimin e ankesave, duke pasur për bazë se ky bord në dhjetë vitet e kaluara nuk ka qenë funksional në masën e duhur, është vendosur edhe me përkrahje të ekspertëve të Komisionit Evropian, që ky bord të riorganizohet dhe të kalojë në një divizion të ankesave pranë gjykatës kompetente.

Prandaj, nga fillimi i vitit 2013 do të përfundojë baza legale, do të punësohen gjyqtarë përmes Këshillit Gjyqësor me procedura të parapara do të trajnohen dhe nga 1 janar do të fillojë shqyrtimi i ankesave nga gjykata kompetente.

Po ashtu, janë marrë hapa të rëndësishëm në përmirësimin e klimës për biznes. Sigurisht, se më vjen mirë se pa dallim, thuaja të gjitha grupet parlamentare, edhe pse realisht Partia Demokratike ka prirë në këtë drejtim, sa i përket përshkallëzimit të TVSH-ës dhe të gjithë po pajtoheni që shumica e vendeve të regjionit e kanë TVSH-ën e përshkallëzuar. Mirëpo, ne do të jemi të kujdesshëm që edhe në reformimin e politikave fiskale t'i kemi gjithmonë në kujdes edhe relacionet në mes të institucioneve ndërkombëtare, ta kemi në kujdes edhe qëndrueshmërinë buxhetore dhe sigurisht se në periudhën e cila është para nesh do të marrim edhe veprime tjera të cilat do të shkojnë në favor të zhvillimit të biznesit.

Kësaj radhe ne kemi paraparë se do të përfitojnë tre sektorë të biznesit: përfitojnë mediat e shkruara dhe elektronike, përfiton sektori i shëndetësisë dhe përfiton sektori i arsimit. Faleminderit shumë për kontributin tuaj!

KRYESUESI: Faleminderit! Ju njoftoj se në sallë janë 76 deputetë. Tani kërkohet deklarimi me votim për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për tatimin mbi vlerën e shtuar.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim dhe votojmë tani:

Konstatohet se me 68 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për tatimin mbi vlerën e shtuar. Faleminderit!

Kërkohet nga komisioni funksional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë Projektligjin dhe Kuvendit t'i paraqesin raportet me rekomandime.

Të nderuar kolegë dhe kolege,

Ju njoftoj se tani është koha për pauzë dhe për të shqyrtuar tekstin e Projektdeklaratës, fillimisht dhe pastaj është pauza e drekës. Pra, në ora 14, do të vazhdojmë me punën e seancë. Faleminderit!

(Ndërhyrje)

Më falni, kemi edhe diçka! Grupi Parlamentar i LDK-ës kërkon të ketë ndryshim lidhur me pushimin.

(Ndërhyrje)

Atëherë, e bëjmë pushimin deri në ora 15 dhe pastaj do të vazhdojmë. Është krejt në rregull. Faleminderit!

(Vijon pauza)

(Seanca vazhdoi punën në ora 15,00)

(Kryeson mbledhjen, nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti)

KRYESUESI: Të nderuar deputetë,
Zoti kryeministër,
Zëvendëskryeministra,
Ministra,
Po vazhdojmë me pikën e pestë të rendit të ditës, që është:

5. Miratimi i Deklaratës së propozuar nga Grupi Parlamentar i PDK-ës, respektivisht kryetari i saj zoti Grabovci.

Sipas pasqyrës që unë e kam, Deklarata është miratuar dhe është harmonizuar nga kryetarët e grupeve parlamentare. Nuk është e nënshkruar vetëm nga kryetari i Grupit Parlamentar të Vetëvendosjes. Në këtë rast, ftoj kryetarin e Grupit Parlamentar zotin Grabovci të PDK-ës si sponsorizues i Deklaratës që ta marrë fjalën.

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, kryesues!
Zoti kryeministër,
Zëvendëskryeministra,
Ministra,
Të nderuar kolegë,

Duke u bazuar në nenin 42 pika 2 si dhe në nenin 49 pika 2 të Rregullores së punës të Kuvendit të Kosovës,

Grupet parlamentare të përfaqësuara në Kuvendin e Republikës së Kosovës, propozojnë këtë

D E K L A R A T Ë:

Lidhur me mbajtjen e referendumit ilegal nga ana e strukturave ilegale serbe në veri të Kosovës.

A r s y e t i m:

Mbajtja e referendumit nga ana e strukturave ilegale serbe në veri të Kosovës ka cenuar rendin kushtetues të Republikës së Kosovës.

Serbia me këtë akt ilegal ka shkelur rendin, sovranitetin dhe integritetin e Republikës së Kosovës.

Andaj, ne konsiderojmë të domosdoshme nxjerrjen e kësaj deklarate.

1. Duke u mbështetur në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, neni 1 pika 1, i cili thotë: Kosova është shtet i pavarur, sovran, demokratik, unik dhe i pandashëm,
2. Të gatshëm për mbrojtjen dhe respektimin e të gjitha konventave ndërkombëtare që garantojnë liritë dhe të drejtat e qytetarëve, si dhe të drejtat e pakicave,
3. Duke shprehur mbështetjen për mbrojtjen dhe realizimin e të drejtave të komuniteteve si dhe implementimin në tërësi të propozimit gjithëpërfshirës për zgjedhjen e statusit final të Kosovës,
4. Duke rikonfirmuar vullnetin për integrim institucional dhe shoqëror të komuniteteve që jetojnë në Republikën e Kosovës,
5. Duke u bazuar në veprimin institucional brenda rregullave që i ofron rendi juridik dhe kushtetues i Republikës së Kosovës,
6. Kuvendi i Republikës së Kosovës e dënon të ashtuquajturin “referendum të organizuar nga strukturat jo legjitime të komunave Mitrovicë, Zveçan, Zubin-Potok dhe Leposaviq” dhe e konsideron cenim të rendit juridik dhe kushtetues të Republikës së Kosovës,
7. Kuvendi i Republikës së Kosovës konstaton se i ashtuquajturi “referendum i organizuar nga strukturat ilegale nuk prodhon asnjë efekt juridik dhe politik” dhe si i tillë është i pavlefshëm,
8. Organizimet e tilla jashtë institucionale dhe ilegale nuk prodhojnë kurrfarë efekti legal dhe kushtetues, por dëmtojnë përpjekjet e vazhdueshme të institucioneve të Republikës së Kosovës për integrim të komunitetit serb në jetën institucionale, dhe
9. Kuvendi i Republikës së Kosovës inkurajon komunitetin serb të pjesës veriore që sa më shpejt të angazhohet në implementimin e propozimit gjithëpërfshirës për zgjedhjen e statusit të Kosovës.

Të nderuar kolegë,

I falënderoj të gjithë shefat e grupeve parlamentare për përkrahjen pa rezervë që na e kanë dhënë gjatë harmonizimit të tekstit të propozuar nga Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës.

Vërejtje kishte në përmbajtjen e tekstit nga shefi i Grupit Parlamentar të Vetëvendosjes që ne e respektojmë vullnetin e tyre, por në këtë rast, për interes të vendit dhe mbrojtjes së vlerave, ju ftoj të gjithëve që ta votojmë këtë deklaratë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Radha është e Grupit Parlamentar të LDK-ës dhe në emër të Grupit Parlamentar, kryetari i Grupit zoti Beqiri, e ka fjalën.

ISMET BEQIRI: Faleminderit zotni kryesues, Unë i kam vetëm dy intervenime. E para, ju kisha lutur që të dihet se kjo deklaratë është e sponsorizuar në një mënyrë ose e propozuar nga grupet parlamentare.

Këtë nuk e them për ndonjë keqkuptim, por është kështoj. Nuk është me rëndësi se kush e ka bërë tekstin, por kjo është e propozuar bashkërisht nga grupet parlamentare poshtë nënshkruese, sepse e keni aty, që është nënshkruar poshtë.

Prandaj, nuk do të duhej me thënë – e propozuar nga PDK-ëja, apo LDK-ëja, por nga grupet parlamentare, atë që e kemi nënshkruar. E para.

Dhe, e dyta. Te pika 6, është përvjedhur një gabim “Kuvendi i Republikës së Kosovës e dënon të ashtuquajturin referendum të organizuar nga strukturat jo legjitime” duhet t’i shtohet “dhe ilegale”. “Dhe ilegale”, sepse nuk është njësoj në terminologjinë juridike, e dinë juristët, dhe vazhdon teksti më tutje “jo legjitime dhe ilegale”.

Dhe me këtë tekst, ne e kemi harmonizuar, do të thotë si kryetarë të grupeve, dhe ne e mbështesim këtë deklaratë dhe do ta votojmë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar Vetëvendosje, zoti Ymeri e ka fjalën.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryesues! Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje, do të abstenojë në votimin e kësaj deklarate të Kuvendit meqenëse në të janë përfshirë dy pika të panevojshme, të dyja këto që e thërrasin dhe e betonojnë zbatimin e planit të Ahtisarit, si dhe për shkak që mungon një pikë tjetër në të, e cila do të kërkonte nga ekzekutivi masa konkrete në pengimin e mbajtjes së një referendumi të tillë i cili është duke u mbajtur në komunat e pjesës veriore.

Plani i Ahtisarit nuk është zgjidhje as për Kosovën as për veriun e Kosovës. Plani i Ahtisarit është faktikisht problemi. Në të hidhet fara e ndarjes së Kosovës në vija etnike e fetare, duke e krijuar njëkohësisht asimetri në kompetenca dhe mundësi në mes komunave të Kosovës. Komunat me shumicë serbe, ato ekzistuese si dhe ato të krijuara me planin e Ahtisarit kanë shumë më shumë kompetenca se sa komunat tjera në Kosovë. Kjo asimetri është pabarazi, e natyrisht pabarazia e parandalon integrimin.

Integrimi kundër ndarjes dhe diskriminimit është parimi dhe e drejta fundamentale njerëzore. E plani i Ahtisarit ndanë dhe diskriminon. E si mundet ky njëkohësisht pastaj edhe të integrojë?

Për shembull, plani i Ahtisarit e ndanë komunën e Mitrovicës në dysh, duke e pranuar kështu spastrimin etnik të strukturave ilegale të Serbisë të vitit 2000 i cili është kryer ndaj shqiptarëve në pjesën veriore të Mitrovicës.

Ne jemi kundër ndarjes së Mitrovicës në dy komuna. Ne jemi për Mitrovicën një komunë, ndërsa plani i Ahtisarit e bën pikërisht këtë – e ndanë Mitrovicën në dy komuna dhe e diskriminon shumicën shqiptare atje.

Ai që po quhet referendum, të cilin strukturat ilegale të Serbisë e kanë organizuar dhe kanë filluar së mbajturi dje, është antikushtetues dhe antiligjor.

Së pari, këto struktura janë të instaluar në Kosovë nga një shtet tjetër. Përmes një procesi zgjedhor i bën nën ombrellën juridike të një shteti tjetër – Serbisë dhe këto zgjedhje ilegale dhe antikushtetuese nuk u penguan asnjëherë nga Qeveria e Kosovës. Të fundit janë mbajtur në vitin 2008 pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës.

E njëjta gjë ndodhi edhe me referendumin, prandaj është e domosdoshme që të kërkohet nga Qeveria e Kosovës që të ndërmarrë masa për shtrirjen e sovranitetit dhe ligjshmërisë në këtë pjesë të Kosovës në mënyrë që aktet e tilla antiligjore e antikushtetuese të parandalohen.

Kuvendi është mirë të dalë me një deklaratë për ta dënuar referendumin, mirëpo kjo deklaratë është e mangët pa këtë kërkesë ndaj Qeverisë. Madje-madje, bëhet faktikisht deklaratë impotente.

Mosintervenimi i Qeverisë do të thotë se Qeveria e Republikës së Kosovës nuk është Qeveri sovraane, jo vetëm ndaj Serbisë, por madje as ndaj strukturave të saj të instaluar brenda shtetit tonë.

Reagimi i Qeverisë ndaj referendumit të këtyre strukturave ka qenë kështu: Referendumi nuk do të ketë efekte.

Kjo nuk është Qeveri sovraane ekzekutive. Kjo është Qeveri e analistëve. Ata na tregojnë se a do të ketë apo jo ndonjë akt të efekteve, dhe pa ndërmarrë asgjë. Dhe nuk kanë thënë fare nëse është apo nuk është i ligjshëm ky referendum.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës, në nenin 2, paragrafi 2, pra si shtesë e asaj që u përmend në Deklaratë, neni 1 paragrafi 1, e obligon ekzekutivin ta mbrojë sovranitetin dhe integritetin territorial duke thënë, po citoj: “Sovraniteti dhe integriteti territorial i Republikës së Kosovës është i pacenueshëm, i patjetërsueshëm dhe i pandashëm dhe mbrohet me të gjitha mjetet e përcaktuara me këtë Kushtetutë”. E, Qeveria e Kosovës po shikon se çfarë po ndodhë në veri, duke mos ndërmarrë asnjë hap atje. Pra, nuk po e mbron as sovranitetin as integritetin territorial të Kosovës.

Prandaj, për këto dy pika, dy pikat shtesë të panevojshme në këtë deklaratë dhe për këtë pikë shumë të rëndësishme e cila i mungon Deklaratës ne do ta abstenojmë në votim këtë deklaratë të Kuvendit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-ës, zoti Gjini e ka fjalën.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Gjithsesi Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e voton Deklaratën që e ka propozuar vetë, fundi i fundit dhe eksti fillon me:

“Duke u bazuar në nenin 42 pika 2, si dhe nenin 49 pika 2 të Rregullores së punës të Kuvendit të Kosovës, grupet parlamentare të përfaqësuara në Kuvendin e Republikës së Kosovës e propozojnë këtë deklaratë”, dhe do të thotë një deklaratë të tillë e mbështesim dhe me siguri se duhet t’i shtojmë kësaj që edhe për atë pjesë të veriut të Kosovës që tani këtë referendum e konsiderojmë si të pa efektshëm, legalisht dhe konsitucionalisht, duhet të implementohet vetëm propozimi gjithëpërfshirës i presidentit Ahtisari. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, deputetja Selmani e ka fjalën!

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, zotëri nënkryetar!

Duke u bazuar në Deklaratën e nënshkruar nga të gjitha grupet parlamentare, siç u potencua edhe pak më parë, me përjashtim të Grupit Parlamentar të Vetëvendosjes, Grupi Parlamentar i koalicionit për Kosovë të Re e përkrah Deklaratën dhe i fton institucionet që në pjesën veriore të Kosovës dhe minoritetet, që të zbatojnë pakon e presidentit Ahtisari, siç është zbatuar edhe një pjesë tjera të Kosovës. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të SLS, deputeti Sasha Millosavljeviq.

SAŠA MILOSAVLJEVIĆ: Hvala, gospodine predsedavajući!

I Samostalna liberalna stranka će podržati Deklaraciju i glasaćemo za Deklaraciju.

KRYESUESI: Faleminderit! 6+, zonja Balje!

DUDA BALJE: Zahvaljujem!

U konsultaciji sa svim šefovima grupa, sugestijama i delimičnim korekcijama finalizovala se Deklaracija, u kojoj Parlamentarna 6+ podržava sve tačke kao i Deklaraciju u celini, i glasaće za nju. Zahvaljujem!

KRYESUESI: Faleminderit! Radha është e deputetëve. Fjalën e ka zoti Hamiti!

SABRI HAMITI: Zotni, Haliti, kryesues!

Zotni kryeministër,

Zotni zëvendëskryeministër,

Ministra,

Kolegë të nderuar,

Ne e respektojmë punën që e kanë bërë shëfat e grupeve parlamentare dhe e kanë ndërtuar një tekst për një problem, për të cilin kërkojnë që Kuvendi të deklarohet.

Dhe meqë këta të gjithë kërkojnë që Kuvendi duhet të deklarohet për një dokument kaq të rëndësishëm, konsideroj që duhet t'i kushtohet një vëmendje e jashtëzakonshme ndërtimit të teksteve të tilla, që mos të bëhen si shenjë të politikës ose si shenja politikaneske të momentit, sepse këto bëhen dokumente obliguese dhe më vonë ua sheh ose hajrin ose sherrin.

Domethënë janë obliguese. Dhe meqë janë të tilla, kërkoj që të dihet se Kuvendi është organ shumë serioz kur merr vendime të tilla dhe vendimet e tij janë obligative sepse është organi më i lartë - përfaqësues i Republikës së Kosovës.

Unë e pashë, tashi shpejt në dorë e pata këtë deklaratë dhe u përpoqa ta shoh sa më shpejt e më mirë që mundem. Dhe mendoj se kjo deklaratë mund të votohet nëse: ruhet pika 1, pika 2. Bie pika 3, ruhet pika 4, pika 5. Bie pika 6, pika 7 dhe pika 8. Ruhet pika 9. Ndërsa, aty pas pikës 4 të shkruhet:

“Kuvendi i Republikës së Kosovës e kundërshton, e shpall të paligjshëm e të pavlefshëm referendumin e strukturave paralele në komunat veriake të Kosovës të financuara e të drejtuara nga Republika e Serbisë kundër pavarësisë, sovranitetit dhe integritetit territorial të Republikës së Kosovës”.

Pika vazhduese - që i bie 2, tash në këtë variantin tim:

“Obligohen të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës të sillen konform Deklaratës së Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe Kushtetutës së Republikës së Kosovës” dhe vazhdon i fundit dhe mbetet ky:

“Kuvendi i Republikës së Kosovës e inkurajon komunitetin serb që të hyjë në strukturimet politike dhe institucionale të Kosovës”.

Nëse pranohen këto, unë kujtoj se janë tepër të rëndësishme sepse esenca saktësohet. Është pak e shkapërderdhur kjo nëpër pika por duhet të jemi të qartë dhe nëse kërkojmë që Parlamenti të artikulohet për këto probleme, sepse nuk mund të shkojmë qorrazi, të thuhet: kush po e bën referendumin pasojat që do t'i krijojë ai janë pasoja të mëdha dhe ato duhet të shpallen jo legale e të pavlefshme dhe të kundërshtohen nga Kuvendi.

Kështu që, ky është propozimi im. Natyrisht, nëse i përkrahni këto, unë do ta jap votën time. E nëse jo, do ta arsyetoj pse s'e jap.

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Bajrami!

ARSIM BAJRAMI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

I nderuar kryeministër,

Zëvendëskryeministra,

Kolegë ministra,

Deputetë,

Fillimisht unë mendoj se reagimi i Kuvendi të Kosovës përmes një deklarate është një akt jashtëzakonisht i qëlluar dhe i domosdoshëm karshi këtij provokimi të rendit kushtetues dhe mendoj se kjo deklaratë në mënyrë të qartë shpreh qëndrimin politik të Kuvendit të Kosovës ndaj këtij provokimi që i bëhet rendit kushtetues.

Janë tri elemente që dominojnë në Deklaratë dhe që janë thënë jashtëzakonisht mirë. E para është që organizimi i këtij të ashtuquajtur "referendum" bëhet nga autoritetet jo kushtetuese dhe jo ligjore. Nuk kisha me thënë ilegale, sepse nuk është term që duhet ta përdor Kuvendi, por poenta është e qartë në Rezolutë se organizimi i këtij të ashtuquajtur "referendum" bëhet nga strukturat jo kushtetuese dhe jo ligjore të cilat nuk kanë as legalitet, as legjitimitet në Republikën e Kosovës.

Çështja e dytë. Objekti i këtij referendum është i ndaluar me Kushtetutën e Kosovës. Edhe pse Kushtetuta e Kosovës e njeh referendumin si mekanizëm demokratik, nuk e lejon referendumin për bazat e sistemit kushtetues dhe sistemit politik të Republikës së Kosovës.

Dhe çështja e tretë. Në Rezolutë në mënyrë të qartë është thënë se Kuvendi i Kosovës, njësoj siç ka deklaruar dje edhe Qeveria e Kosovës, konsideron se ky referendum nuk prodhon asnjë efekt juridik dhe asnjë efekt politik në raport me Republikën e Kosovës.

Gjithashtu, në tekstin e rezolutës që është dokument politik, nuk është dokument juridik, nuk përbëhet prej neneve por përbëhet prej disa qëndrimeve politike që i shpreh Kuvendi, në mënyrë të qartë Kuvendi bën me dije që e vetmja zgjidhje për pjesën veriore të Kosovës është implementimi i planit gjithëpërfshirës dhe i bën ftesë qytetarëve të Republikës së Kosovës që jetojnë në atë pjesë të Republikës së Kosovës që të marrin pjesë në realizimin e të drejtave kushtetuese që i njeh apo i përcakton ky plan gjithëpërfshirës.

Vlerësoj se dokumenti shpreh një qëndrim të qartë politik dhe si i tillë mendoj se është një detyrim kushtetues të cilin Kuvendi po e realizon përmes kësaj deklarate. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputetja Lama, e ka fjalën!

ALMA LAMA: Faleminderit, zoti kryesues!

Padyshim që reagimi në lidhje me atë që po ndodh në veri, është i domosdoshëm, mirëpo duhet të jemi shumë të vëmendshëm për të kuptuar se çfarë po ndodhë atje, ose për t'ia dhënë vendin që e meriton në këtë deklaratë asaj që po ndodhë atje.

Sepse, mesa lexova në tekstin e shkruar këtu, ky tekst nuk i përgjigjet një pyetjeje, ose dy pyetjeve, në fakt. Pra pyetjes – kush dhe pse, kush qëndron pas këtij referendumi dhe pse? Asnjëra nga këto pyetje nuk ka marrë përgjigje në këtë deklaratë dhe si të tillë, e konsideroj të mangët.

Duhet ta themi qartë se pas këtij referendumi qëndron Beogradi zyrtar, pavarësisht nga deklaratat që i kemi dëgjuar ditëve të fundit sikur e gjithë kjo po bëhet me kokën e disa përfaqësuesve jo legjitimë të komunave në Mitrovicë. Në fakt për Beogradin këta nuk janë përfaqësues jo legjitimë, por janë pikërisht të zgjedhur prej tyre.

Së dyti. Duhet të kemi parasysh që megjithëse Kosova është vendi më i mbikëqyrur ndërkombtarisht, as nga bashkësia ndërkombëtare dhe as nga Qeveria e Kosovës deri tani nuk është ndërmarrë asnjë hap për ta penguar këtë referendum.

Së treti. Ajo që po ndodh atje, na nxjerr një mësim shumë të vlefshëm, ose disa të dhëna shumë të rëndësishme, që qytetarët serbë, atje në veri, pjesa më e madhe, qytetarët e kam fjalën, nuk janë të lirë, janë të shantazhuar. Së paku nga raportimet e mediave që i kemi dëgjuar, ata kanë pasur presion të madh për të dalë në votime dhe numri i votuesve ka qenë mjaft i vogël. Kjo tregon se gjëja kryesore që duhet të bëhet në veri është çlirimi i qytetarëve të thjeshtë serbë të cilët ndihen të shantazhuar nga disa struktura kriminale dhe nuk e di pse askush s'e merr parasysh këtë fakt.

Dhe, së katërti. Duhet të ju rikujtoj se në vitin 2006 në Serbi është zhvilluar një referendum, ku për herë të parë Kosova është bërë pjesë e territorit të Serbisë. E gjithë bashkësia ndërkombëtare në atë kohë ishte kundër këtij referendumi, mirëpo sot si ka ndryshuar kjo qasje. Askush nuk po i kërkon Serbisë që ta ndryshojë Kushtetutën e saj ku e ka futur Kosovën me referendum pra aty.

Pra, një referendum që i kishte kundër të gjithë, sot merret si i ligjshëm. Frika ime është se edhe këta gjysmë zëra sot, që i konsiderojnë të paligjshëm rezultatet e referendumit, nesër mund t'i marrin si legjitime. Dhe, së paku nga eksperiencia këtu në Kosovë kemi mësuar se kjo ka ndodhur shpesh, veçanërisht në veri të Mitrovicës. Faleminderit!

(Drejton mbledhjen, kryetari i Kuvendit, z. Jakup Krasniqi)

KRYETARI: Faleminderit! Hydajet Hyseni e ka fjalën!

HYDAJET HYSENI: Faleminderit, zoti kryetar!

Zonja e zotërinj deputetë,

Edhe unë, u morr vesh, e mbështes edhe nismën edhe tekstin dhe dua të shquaj faktin që kjo deklaratë edhe kështu siç është shkruar nuk drejtohet kundër komunitetit serb dhe as të drejtave elementare të pjesëtarëve të këtij komuniteti dhe mendoj se është mirë që është theksuar kjo dhe ndoshta duhet të theksohet edhe më shumë. Pra, nuk është, por është në favor të pajtimit kombëtar e ndëretnik në Kosovë dhe normalizimit të gjendjes në Kosovë.

Po ashtu, nuk është theksuar sa duhet dhe për mendimin tim do të duhej theksuar kundërshtimi i organit më të lartë legjislativ të Kosovës me qasjen me dy kute për probleme që janë të ngjashme dhe ekuivalente.

Unë kam disa vërejtje konkrete në tekstin e Deklaratës. Mendoj se pas pikës 1, do të duhej të shtohet edhe një pikë tjetër që do të mund të ishte kështu: “Duke pasur parasysh aktet ndërkombëtare që e njohin tërësinë territoriale të Kosovës”, ku përfshihet edhe propozimi gjithëpërfshirës, edhe një vistër rezolutash, e tjera, që mendoj se kanë rëndësi.

Pika 3 dhe pika 9 e kanë një përsëritje. Të dyja i referohen propozimit gjithëpërfshirës. Mendoj se nuk duhet të jetë kështu. Prandaj, propozoj që në pikën 3 të mbetet vetëm pjesa që ka të bëjë me përkushtimin për realizimin e të drejtave të komuniteteve, të fshihet pjesa “propozimi gjithëpërfshirës për zgjidhjen e statusit final të Kosovës”, sepse është pika 9 që e thotë këtë dhe në vend të saj të shtohet “në pajtim me Kushtetutën dhe standardet e mirënjohura ndërkombëtare”.

Po ashtu, te pika 6, për mendimin tim edhe shprehja “dënon”, do të ishte më mirë të zëvendësohet me “shpall të paligjshëm dhe antikushtetues”. Mendoj se është më juridike dhe më e saktë.

Dhe, ajo që thash, pika 7, që është përsëritje me pikën 8, sidomos te kjo “nuk prodhon asnjë efekt juridik”, atje “nuk prodhon asnjë efekt legal” që është e njëjta gjë, mendoj se duhet që në pikën 7 të fshihet “dhe politik”. “Ndërmarrjet e tilla prodhojnë efekte politike” dhe ne duhet ta dimë këtë dhe duhet ta pranojmë këtë. Po “jo legale, jo juridike”. Prandaj, me atë “politike” duhet të merremi, e me këtë “legale” duhet tu japim përgjigjet në këtë rast.

Prandaj, në pikën 8 propozoj të fshihet kjo “nuk prodhojnë kurrfarë efekti legal”, sepse është thënë në pikën e mëparshme.

Dhe propozoj që në fund të paragrafit 9 ose pikës 9, të shtohet edhe ky tekst: “Propozimi gjithëpërfshirës për zgjidhjen e statusit të Kosovës, i cili po ashtu rilegjitimon tërësinë territoriale të Kosovës” dhe propozoj që të jetë një pikë shtesë: “Kuvendi i Kosovës nuk pajtohet me qasjen për zgjidhjen me kute të ndryshme të problemeve që janë të ngjashme e ekuivalente”. Ju faleminderit!

KRYETARI: Si po duket ka nevojë për një harmonizim të ri pas këtyre diskutimeve. Por para se ta përmbyllim i kemi edhe dy deputetë të lajmëruar për diskutim. Fjalën e ka Sadri Ferati, le të përgatitet deputeti Albin Kurti.

SADRI FERATI: Faleminderit, i nderuari kryetar!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë,

Në mbështetje të Deklaratës që fuqizon kushtetutshmërinë dhe veprimet jo kushtetuese me rastin e organizimit të këtij të ashtuquajtur “referendum”, unë do të doja të kontribuoj vetëm për pikën 6 kur thuhet se “strukturat jo legjitime të komunave, ndër të tjera dhe

Mitrovicë” nuk është e drejtë dhe nuk është edhe në përputhje me ligjet në fuqi, por mund të thuhet “komunat Zveçan, Zubin-Potok, Leposaviq dhe një pjesë, pra në një pjesë të territorit të komunës së Mitrovicës”, sepse kështu si qëndron komuna e Mitrovicës nuk është e drejtë të thuhet sepse nuk po ndodhë në komunën e Mitrovicës. Pra, unë mendoj që në korreksion të kjo kishte me kontribuar drejtësisë së paraqitjes të asaj çka po ndodhë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Albin Kurti.

ALBIN KURTI: Deputetë të Kuvendit të Kosovës,
U tha që referendumi në veri s’do të ketë efekt. Po kjo deklaratë çfarë efekti do të ketë?

Eftetet vijnë vetëm prej fjalëve që pasohen me veprime. Domethënë prej fjalëve që nuk pasohen me veprime prapë s’ka efekte. Duket që një kotësie prej veriut po i përgjigjemi me një kotësi prej Prishtinës.

Pika 7 e kësaj deklarate thotë që “kjo nuk do të prodhojë”, pra: “referendumi nuk do të prodhojë asnjë efekt juridik e politik dhe si i tillë është i pavlefshëm.”.

Mirëpo, pika 8 thotë që “organizimet e tilla jashtë institucionale dhe ilegale nuk prodhojnë kurrfarë efekti legal dhe kushtetues dhe dëmtojnë përpjekjet e vazhdueshme të Republikës së Kosovës për integrim të komunitetit serb në jetën institucionale”.

Domethënë kjo është në njëfarë lloji kundërthënie logjike. Pra nëse i dëmtojmë përpjekjet e vazhdueshme paskan efekt. Nëse themi që s’kanë efekt, atëherë s’munden as me i dëmtuar përpjekjet e institucioneve. Por nëse po i dëmtoikan atëherë paskan efekt. Po kjo, është e palogjikshme brenda vetes.

Nëse qenkan shkel ligjet e Republikës së Kosovës dhe është cenuar rendi juridik dhe kushtetues i Republikës së Kosovës ashtu siç thotë neni 6, atëherë çka do të duhej të bëjë Qeveria dhe institucionet shtetërore lidhur me këtë cenim? Është absurde të konstatohet cenimi, e në anën tjetër të mos thuhet asgjë se çka duhet të bëhet për cenim. Në njëfarë mënyre po tregohet një lloj pafuqie karshi cenimit. Sepse po pranohet cenimi, po konstatohet dhe s’po ndërmerret asgjë. Nuk ka kurrfarë zotimi për sanimin e këtij cenimi.

Në njëfarë mënyre kjo e bënë më të fuqishëm referendumin. Më mirë është mos të bëhet kjo deklaratë se sa të bëhet kështu. Kur konstaton cenim dhe nuk ndërmerr asnjë hapë kundër cenimit t’i po dëshmoresh i pafuqishëm dhe në njëfarë mënyre edhe referendumi nëse nuk ka qenë i vlefshëm dhe u fuqishëm, prej poshtë po e bënë të fuqishëm, me pafuqinë tënde.

Mendoj që strukturat e Serbisë në Kosovë nuk mjafton me i quajt vetëm ilegale, jo legjitime edhe kriminale. Mendoj që duhet me i quajt gjithmonë edhe armiqësore, se Serbia është armik. Dhe shumë problemi, që i kemi në Kosovë, vijnë prej kësaj që nuk quhet Serbia armik por fqinji veriore e kështu me radhë. Prandaj, është temë e gjatë kjo pse po mendoj që duhet të quhen gjithmonë struktura armiqësore - jo pse ne po e shpallim

Serbinë armik, por pse Serbia e ka shpall veten karshi neve armik, prej Kushtetutës së saj e deri tek deklaratat e nëpunësit më të ulët shtetërorë atje.

Ne të Vetëvendosjes, qysh në vitin 2009 patëm ngritur kallëzime penale dhe padi ndaj strukturave ilegale të Serbisë. Mirëpo, prokuroritë nuk kanë vepruar.

Në anën tjetër, as Qeveria e Kosovës, as në mandatin e mëhershëm as sot nuk ka vepruar. Dhe tash është një lloj hipokrizie kjo që lëshohen deklaratat të tilla, atëherë kur kanë ekzistuar mekanizmat, kompetencat dhe përgjegjësi përkatëse që të veprohet.

Mua më duket tërësisht hipokrite që të njëjtit deputetë që i kanë mbështetur bisedimet me Serbinë pa kushte për Serbinë e për çështje të brendshme të Kosovës, të njëjtit deputetë që e kanë iniciuar dhe votuar anti-reciprocitetin me Serbinë, tash janë të njëjtit deputetë që shtiren kinë se po na e mbrojnë rendin kushtetues, juridikë dhe integritetin territorial.

Por bindja ime është e qartë pse është kështu. Synimi është se Qeveria e Kosovës të duket bashkë me subjektet tjera opozitare, tash kur ajo po përgatitet që përfundimisht të heqë dorë nga Republika, ta fusë Kosovën dhe shtetin e saj në fusnotë. I ka pranuar kopjet e regjistrave civilë edhe dokumentacionin kadastral, po përgatitet me e shitur PTK-në, Trepçën edhe KEK-un, edhe për këtë gjë sigurisht që i nevojitet një konsensus më i gjerë.

Edhe një herë po e them atë që e tha Visari, që kurrresi nuk bënë të bëhet komuna e veriut të Mitrovicës. Nëse ky brez i politikanëve nuk është në gjendje ta bashkojë Mitrovicën atëherë e kemi për obligim që brezit të ardhshëm mos ta bëjmë më vështirë.

Pra nuk ke mundësi, s'ke dijeni, s'ke vullnet, ndoshta je i shantazhuar ose ku me ditë çka edhe s'mundesh me bashkua Mitrovicën, mos ia vështirëso brezit të ardhshëm.

Prandaj, është e domosdoshme që kurrresi të mos t'i referohet këtu planit të Ahtisarit dhe kësisoj të thirremi në te, sepse ai na e instalon komunën e veriut të Mitrovicës dhe kësisoj e betonon ndarjen e qytetit që as nuk ka qenë qëllim i shqiptarëve por besoj s'është as interesi i tyre. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Deputet Kurti, për hir të korrektësisë është mirë që të respektohet rendi i ditës. Në rend të ditës e kemi një deklaratë. E para.

Dhe, e dyta. Për shkak të kulturës parlamentare, para se t'i drejtoheni deputetëve të Kuvendit do të ishe krejt në natyrën edhe të kulturës edhe të edukatës të drejtoresh kryetarit të Kuvendit kur e udhëheqë seancën kryetari i Kuvendit, dhe kur është nënkryetari t'i drejtoheni nënkryetarit të Kuvendit. Dhe është mirë ta respektoni këtë institucion, se ky institucion është i qytetarëve të Kosovës. Nuk është as i Partisë Demokratike, as i Vetëvendosjes dhe as i një partie tjetër politike. Fjalën e ka deputeti Ismet Beqiri.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, zotni kryetar!

Ne u konsultuam dhe ramë dakord që këtij teksti t'i shtohet një pikë, pas pikës 5 të bëhet 6 dhe teksti të zhvendoset tërësisht në numrat dhe realisht bëhen 11. Mos të gabohem, vërtetë i kemi këtu 9 dhe bëhen 10. Domethënë 10 pika dhe ne propozojmë, do të thotë, bashkërisht në konsultim me shefat e grupeve që të jetë një pikë dhe kjo është kështu:

“Kuvendi i Republikës së Kosovës e kundërshton, e shpall të paligjshëm e të pavlefshëm referendumin e strukturave paralele në komunat veriake të Kosovës të financuara e të drejtura nga Republika e Serbisë kundër pavarësisë, sovranitetit dhe integritetit territorial të Republikës së Kosovës”

Kjo është ajo. Dhe, ne e mbështesim dhe do ta votojmë. Pra, po flas tash me qenë se u morëm vesh të gjithë kryetarët e grupeve parlamentare. Pra, ky ishte propozim i profesor Hamitit dhe ishim plotësisht dakord. Faleminderit!

KRYETARI: Unë jam dakord edhe me atë që e tha deputeti Sadri Ferati, që Mitrovica mos të jetë aty se vërtetë ajo është një tërësi dhe, kështu siç është, nuk është mirë me qenë. Do të thotë duhet të jetë ashtu siç është në realitet.

Dhe, meqenëse unë e kam edhe një vërejtje që mund ta kalojmë kështu siç është tani, por këto strukturat paralele nuk janë bash paralele. Ne mund t'i quajmë edhe kështu siç po i quajmë, por po ju them sinqerisht ka me ardhur një ditë e shpejtë dhe kemi me i quajtur me emrin e tyre të vërtetë, dhe emri i tyre i vërtetë, mund të them tash: është agresion i Serbisë në një pjesë të territorit të Republikës së Kosovës.

(Ndërhyrje)

A po e harmonizoni në tërësi Deklaratën apo po e lëmë me këto vërejtjet që u thanë?

(Ndërhyrje)

E harmonizuar, ashtu siç e the.

Atëherë lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim dhe votojmë tash:

Prezentë i kemi 82 deputetë.

Konstatoj se “për” kanë votuar 64 deputetë, “kundër” asnjë dhe 9 kanë abstenuar. Pa kartelë nuk ka.

Do të thotë, miratohet Deklarata, me korrigjimin që e tha edhe kryetari i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës. Faleminderit!

(Ndërprerje e shkurtër e incizimit)

Vazhdojmë me pikën e gjashtë të rendit të ditës.

6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për shërbimet këshilluese për bujqësi dhe zhvillim rural.

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për shërbime këshilluese për bujqësi dhe zhvillim rural dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Ftoj kryetarin e komisionit funksional për bujqësi, pylltari, zhvillim rural, mjedis dhe planifikim hapësinor, deputetin Nait Hasani që para deputetëve të arsyetojë raportin me rekomandime. Atëherë, meqë është bërë një ndryshim këtu, dhe deputeti Salih Morina, e ka fjalën.

SALIH MORINA: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Komisioni funksional - Komisioni për Bujqësi, Pylltari dhe Mjedis e ka shqyrtuar Projektligjin dhe njëkohësisht gjatë kësaj periudhe për leximin të dytë ka formuar edhe komisionet punuese dhe njëkohësisht në pajtim me Ministrinë si sponsorizues i këtij ligji ka bërë disa ndryshime në kuadër të disa amendamenteve, por ato më tepër kanë qenë të karakterit teknik se sa të karakterit profesional dhe njëkohësisht të gjitha komisionet që janë në kuadër të parlamentit duke u nisur nga Komisioni për Legjislacion, Komisioni për Buxhet, Komisionit për Komunitete dhe Komisioni për Integritet - kanë rekomanduar që ky projektligj të aprovohet edhe në leximin e dytë.

Andaj, në emër të komisionit funksional, i ftoj të gjithë deputetët e Parlamentit të Kosovës që ta miratojnë këtë projektligj për votim. Faleminderit, shumë!

KRYETARI: Faleminderit!

Atëherë vazhdojmë me votimin e amendamenteve propozuara në këtë projektligj.

Amendamenti 1.

A ka “kundër”

Ka abstenim, s’ka,

Miratohet amendamenti 1.

Amendamenti 2.

“Kundër” nuk ka,

Abstenim, nuk ka,

Miratohet amendamenti 2.

Amendamenti 3.

“Kundër” nuk ka,

Abstenim, nuk ka,

Miratohet amendamenti 3.

Amendamenti 4.

“Kundër” nuk ka,

Abstenim, nuk ka,
Miratohet amendamenti 4.

Amendamenti 5.
“Kundër” nuk ka,
Abstenim, nuk ka,
Miratohet amendamenti 5.

Amendamenti 6.
“Kundër” nuk ka,
Abstenim, nuk ka,
Miratohet amendamenti 6.

Amendamenti 7.
“Kundër” nuk ka,
Abstenim, nuk ka,
Miratohet amendamenti 7.

Amendamenti 8.
“Kundër” nuk ka,
Abstenim, nuk ka,
Miratohet amendamenti 8.

Amendamenti 9.
“Kundër” nuk ka,
Abstenim, nuk ka,
Miratohet amendamenti 9.

Dhe amendamenti 10.
“Kundër” nuk ka,
Abstenim, nuk ka,
Miratohet amendamenti 10.

Tash e votojmë Ligjin në tërësi.
Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim dhe votojmë tash:
Prezentë janë 65 deputetë.

Konstatohet se me 60 vota “për”, asnjë “kundër” dhe asnjë abstenim, Kuvendi e miratoi Ligjin për shërbime këshilluese për bujqësi dhe zhvillim rural. Faleminderit!

Vazhdojmë me pikën e shtatë të rendit të ditës.

7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për arkivat.

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për arkivat dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Ftoj kryetarin e Komisionit funksional për arsim, kulturë, rinë, sport, administratë publike, qeverisje lokale dhe media, deputetin Idriz Vehapi, që para deputetëve ta arsyetojë Raportin me rekomandime.

IDRIZ VEHAPI: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Komisioni funksional e ka shqyrtuar Projektligjin dhe i ka dhënë amendamentet e tij. Projektligji është shqyrtuar edhe nga komisionet e përhershme, të cilat nuk kanë pasur vërejtje, prandaj si Komision një zëri i propozojmë seancës që ta miratojë Projektligjin me amendamentet e propozuara. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Të lajmëruar për diskutim nuk ka. Shkojmë në votimin e amendamenteve.

Amendamenti 1.

A ka “kundër”?

Abstenim, nuk ka,

Miratohet amendamenti 1.

Amendamenti 2.

“Kundër” nuk ka,

Abstenim nuk ka,

Miratohet amendamenti 2.

Amendamenti 3.

“Kundër” nuk ka,

Abstenim nuk ka,

Miratohet amendamenti 3.

Amendamenti 4.

“Kundër” nuk ka,

Abstenim nuk ka,

Miratohet amendamenti 4.

Amendamenti 5.

“Kundër” nuk ka,

Abstenim nuk ka,

Miratohet amendamenti 5.

Tani e votojmë Ligjin në tërësi.

Prezentë janë 63 deputetë.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim dhe votojmë tash:

Konstatohet se me 59 vota “për”, asnjë “kundër” dhe asnjë abstenim, Kuvendi e miratoi Ligjin për arkivat shtetërore. Faleminderit!

Vazhdojmë me pikën e tetë të rendit të ditës.

8. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Inspektoratin e Punës.

Komisioni për shëndetësi, punë dhe mirëqenie sociale e ka shqyrtuar Raportin për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Inspektoratin e Punës dhe Kuvendit i paraqet raportin me rekomandime.

Lus raportuesen e Komisionit për shëndetësi, punë dhe mirëqenie sociale, deputeten Nazane Breca, që para deputetëve ta arsyetojë raportin me rekomandime.

(Ndërhyrje)

Mungon, deputetja. Por, këtu po thotë raportuesja e Komisionit për shëndetësi, punë dhe mirëqenie sociale është deputetja Nazane Breca. Atëherë, kush do ta marrë fjalën? Atëherë, e ka fjalën deputeti Salih Morina.

SALIH MORINA: Kryetar, kërkojmë falje, se raportuesja për pak minuta do të kthehet, se nuk është për momentin, pra nëse ka mundësi ose me kaluar në pikën tjetër të rendit të ditës.

KRYETARI: E kërkon fjalën kryetari i Komisionit Fikrim Damka. Regjia fjalën deputetit Fikrim Damka.

FIKRIM DAMKA: Faleminderit, kryetar!

Pasi që Nazanja nuk është këtu, unë si kryetar kërkoj mbështetje për këtë raport të ligjit lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit.

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputetja Salihe Mustafa.

SALIHE MUSTAFA: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike, e ka shqyrtuar Raportin e Komisionit për shëndetësi, punë dhe mirëqenie sociale dhe vërejtjet e rekomandimet e dala nga ky Komision, Grupi Parlamentar i përkrahë.

Gjithashtu, e përshëndesim Vendimin e Ministrisë Punës dhe Mirëqenies Sociale për rritjen e numrit të inspektorëve të punës. Dhe, megjithatë edhe ky numër nuk është i mjaftueshëm.

Gjithashtu është i domosdoshëm plotësimi i kushteve të punës së Inspektoratit të Punës, siç janë: zyrat, makinat, pajisjet teknike, pagesa e rrezikshmërisë në punë e tjera, por do të duhej edhe një mbikëqyrje më e madhe e punës së Inspektoratit të Punës nga Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale për arsye se gjatë monitorimit kemi hasur disa raste ku inspektorët e punës, edhe pse pak në numër, disa biznese kanë arritur që t'i vizitojnë disa herë gjatë vitit, e shumë të tjera asnjëherë. Kjo ka ndodhë në disa komuna të Kosovës.

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale e ka nënshkruar Marrëveshjen e mirëkuptimit me disa komuna dhe kërkojmë që ky bashkëpunim në të ardhmen të vazhdojë, pasi që dihet se Inspektoratin e Punës e zgjedh Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, ndërsa inspektorët e punës veprojnë nëpër komuna.

Prandaj, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike konsideron se Ligji për Inspektoratin e Punës ka nevojë të plotësohet dhe ndryshohet dhe e mirëpresim nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale që ky ligj me plotësim ndryshime të vijë në Kuvend dhe ne si Grup Parlamentar do ta japim kontributin tonë gjatë plotësim-ndryshimit të këtij ligji. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Deputetja Nazane Breca. Dhe, a merr fjalën në emër të Lidhjes Demokratike a të Komisionit?

NAZANE BRECA: Faleminderit, kryetar!

I nderuari kryetar,

Të nderuar deputetë,

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale në Planin e punës së vetë ka paraparë mbikëqyrjen e Ligjit mbi Inspektoratin e punës që ndërlidhet edhe me Ligjin e punës.

Komisioni e ka formuar edhe Grupin punues i cili i ka bërë vizitat e duhura dhe ka bërë mbledhjen e informatave. Mbledhja e informatave të nevojshme nga Komisioni është zhvilluar në disa faza:

- mbledhja e informatave nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Inspektorati i Punës,
- mbledhja e informatave nga niveli lokal,
- mbledhja e informatave nga vizitat në kompanitë private.

Dhe, në bazë të informatave të mbledhura, Komisioni ka arritur në këto konkluzione:

Ligji për inspektoratin e punës nuk po zbatohet plotësisht si pasojë e disa mangësive të ligjit dhe mos efikasitetit të institucioneve përgjegjëse për zbatim.

Me qëllim të ndryshimit dhe përmirësimit të gjendjes aktuale dhe me qëllim të rritjes së nivelit të zbatimit të këtij ligji, Komisioni i propozon këto rekomandime:

Qeveria e Kosovës, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe organet tjera përgjegjëse duhet të rrisin përpjekjet për zbatimin e Ligjit.

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe kuvendet komunale duhet të rrisin bashkëpunimin dhe t'i koordinojnë veprimet në mënyrë që të zbatohet në tërësi Ligji për Inspektoratin e Punës.

Ministria duhet të nxjerr dhe harmonizoj udhëzimet administrative me Ligjin e punës dhe Ligjin për rrezikshmërinë në punë në mënyrë që Ligji për Inspektoratin e Punës të zbatohet plotësisht.

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale duhet të rrisë numrin e inspektorëve të punës dhe t'i mbulojë të gjitha komunat me inspektorë të punës.

Nga takimet e vizitat në nivelin qendrorë dhe lokal shihet nevoja e plotësim- ndryshimit të Ligjit apo e hartimit të një ligji të ri për Inspektoratin e Punës.

Rekomandimi shtesë:

Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale duhet t'i raportojë Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale për nivelin e zbatimit të ligjeve së paku një herë në vit.

Kjo përgjegjësi e Ministrisë buron nga rregulla 73, paragrafi 2 i Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës.

Ftoj deputetë që t'i miratojnë rekomandimet e Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale.

Detalet e raportit janë në materiale të cilën e kanë marrë deputetët, kështu që nuk do të hy në detale të raportit.

Tash, në qoftë se më lejoni, unë do të flas edhe në emër të Grupit Parlamentar të LDK-ës.

Grupi Parlamentar i LDK-ës e ka shqyrtuar këtë raport dhe e përkrah Raportin e Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale.

KRYETARI: Faleminderit, deputete! Fjalën e ka deputeti, Visar Ymeri.

VISAR YMERI: Faleminderit!

Edhe ne e kemi shqyrtuar këtë raport, në të cilin janë vë në pah disa prej, të them ashtu, dështimeve të Qeverisë në zbatimin e Ligjit për Inspektoratin e Punës. Dhe, për shembull, thuhet që nuk janë nxjerr të gjitha aktet nënligjore për zbatimin e Ligjit të punës dhe disa akte për rrezikshmërinë dhe sigurinë në punë dhe këto, natyrisht, që e pengojnë pastaj edhe zbatimin e Ligjit për kryerjen e punës nga Inspektorati. Pra, është një prej aspekteve që e pengon Inspektoratin që të jetë efikas në punë edhe po të kishte qenë ky inspektorat në gjendjen të cilën duhet e që qartazi raporti e tregon që nuk është.

Një çështje tjetër, e cila po ashtu duhet të vihet në pah, mendoj unë, është domethënë edhe numri që të sanohet ky problemi që e kemi me numrin e vogël të inspektorëve të punës. Pra, në disa raste kemi parë që edhe kuvendet komunale por në përgjegjësi edhe Ministria arsyetohet që nuk po ka mundësi që në fakt ta mbikëqyrë me përpikëri zbatimin e ligjeve të punës, veçanërisht për punëtorët në sektorin privat, për shkak të numrit të vogël të inspektorëve të punës si dhe për shkak të mungesës së kushteve minimale të punës ose për punë që i kanë këta inspektorë.

Ndërkohë, e dimë që në fakt Ligji i punës në Kosovë nuk është duke u zbatuar siç duhet, ka pasur dhe vazhdimisht ka ankesa të ndryshme nga një pjesë e konsiderueshme e punëtorëve në punë që iu shkelen të drejtat madje elementare në punë, jo vetëm në aspektin e rrezikshmërisë në punë por edhe në aspektin e përfilljes së ditëve të pushimit, ditëve të festës, pagesës për këto ditë, e kështu me radhë. Pra, konsiderojmë që kjo pozitë e punëtorëve në Kosovë domosdoshmërisht duhet të përmirësohet dhe Inspektorati i Punës do të duhej të ishte ai i cili e bartë barrën kryesore në identifikimin dhe përndjekjen e këtyre rasteve.

Te pika 5 e Raportit thuhet që është konstatuar se ka vizita të shpeshta të inspektorëve të punës në disa kompani dhe në disa kompani nuk ka fare, ose ka shumë radhë.

Pra kjo do me thanë se një lloj selektiviteti bëhet aty i cili konsideroj unë nuk është i drejtë dhe nuk është në përputhje me parimin e mosdiskriminimit në Kosovë dhe nuk e di se si merren këto vendime për këto vizita të shpeshta në disa kompani e mos me bë vizita në kompani tjera, mirëpo kjo zgjon një dyshim për mënyrën se si punon Inspektorati i Punës, i cili duhet të sanohet natyrisht nga Qeveria.

E kemi po ashtu një vërejtje te rekomandimet. Rekomandimi 1, të cilin po e citoj, lexon kështu: “Qeveria e Kosovës, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe organet tjera përgjegjëse duhet të rrisin përpjekjet për zbatimin e ligjit.”.

Kjo të rrisin përpjekjet, nuk është kurrfarë rekomandimi. Ky është një lloj abstraksioni i cili mendoj që nuk zgjidhë kurrgjë.

Çka nënkupton me i rritur përpjekjet? Do me thënë duhet të kemi rekomandime konkrete të cilat e ftojnë Qeverinë dhe e obligojnë në fakt Qeverinë që ta merr këtë ligj dhe Inspektoratin e Punës në përgjithësi më seriozisht dhe ta instalojë atë sipas nevojave që i ka Kosova dhe veçanërisht punëtorët e Kosovës. Ju faleminderit!

KRYETARI: Deputeti Ardian Gjini, e ka fjalën.

ARDIAN GJINI: Ju faleminderit, zoti kryetar!

Shumë shkurt. Edhe Grupi Parlamentar i Aleancës e mbështetë Raportin që ka ardhur nga Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Koalicionit për Kosovë të Re, Gëzim Kelmendi e ka kërkuar fjalën.

GËZIM KELMENDI: Ju faleminderit, i nderuari kryetar!

Të nderuar deputetë,

Edhe Koalicioni për Kosovë të Re e përkrahë këtë rekomandim të Komisionit për Shëndetësi, por vërejtjet kryesore do të jetë kryesisht në pikën 2 ku kemi të bëjmë të rritja e bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Punës dhe të Mirëqenies Sociale dhe të kuvendeve komunale, nga se aktualisht me Ligjin për Inspektoratin e Punës inspektorët emërohen në bazë të marrëveshjes, do të thotë në kompetencë të kuvendeve komunale, ndërsa aktualisht një gjë e tillë nuk ndodhë nga se inspektorët e tillë, aktualisht ende vazhdojnë të emërohen në postet e tyre nga Ministria e Mirëqenies së Punës dhe të Mirëqenies Sociale, që një gjë e tillë është në kundërshtim me Ligjin aktual në fuqi.

Prandaj për ne si Komision, vërejtjen kryesore e kemi pas mu në këtë pikë nga se aktualisht nuk zbatohet ligji dhe për atë arsye dalin këto parregullsi në pah dhe kemi mos koordinim në mes të Inspektoratit dhe kuvendeve komunale. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të SLS-ës deputeti Sasha Millosavleviq e ka fjalën. Regjia, fjalën deputetit Sasha Milosavleviq.

SAŠA MILOSAVLJEVIĆ: I parlamentarna grupa Samostalne liberalne stranke podržava ovu tačku i glasamo za. Hvala!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar “6+”, nuk është lajmëruar askush. Atëherë fillojmë me deputetët. Fjalën e ka deputeti Zenun Pajaziti.

ZENUN PAJAZITI: Ju faleminderit, zotëri kryetar!

Në mbështetje të këtij dokumenti - të këtij raporti, duke e përgëzuar punën e deputetëve në mbikëqyrjen e zbatimit të këtij ligji, mendoj se edhe një prej rekomandimeve është se duhet të bëhet plotësimi i këtij ligji, kjo i lë në hije të gjitha ato që mund të thuhet në ndërkohë, por megjithatë unë mendoj se ka diçka që ka mbetur nga Grupi Punues, ose që është dashur të trajtojë dhe është fjala për ato që mund të dalin nga Raporti i progresit për këtë institucion.

Pra, ka qenë një kohë të gjatë ose në disa prej raporteve ose një prej sfidave që ky institucion kaq i rëndësishëm që i rregullon marrëdhëniet e punës së punëtorëve, relacionin me punëmarrës në tregun e punës e tjerë, ky institucion të ketë një databazë ose një bazë elektronike të dhënave, që është një mangësi dhe është përsëritë.

E di se Ministria ka filluar me bë diçka në këtë drejtim, por është krejtësisht absurde që ky institucion kaq i rëndësishëm ose këta njerëz inspektorë të mos ta kenë një bazë të dhënave unike që është me Administratën Tatimore, me Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, dhe me departamentin përkatës thjeshtë të kërkohet që një inspektor gjatë punës së tij ta ketë të paktën një llap-top për kyçje në këtë databazë dhe kudo që të

shkojë ta ketë një bazë të dhënave unike për secilindo prej punëtorëve ose bizneseve që mund t'i qaset ky punëtor, apo zyrtar.

Prandaj, mendoj se është dashur të trajtohet edhe relacioni i këtij institucioni me Komisionin Evropian ose me atë, që tashmë është bërë i popullarizuar si Raport progresi, që mund të ballafaqohemi edhe në fazën vijuese me të njëjtën sfidë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Deputeti Armend Zemaj, e ka fjalën.

ARMEND ZEMAJ: Ju faleminderit, kryetar!

Së pari dua të them se duhet të respektohet puna e Grupit punues, si pikë e parë, dhe e vetë Komisionit për një punë të mirë që edhe i takon Kuvendit të Republikës së Kosovës - mbikëqyrja e zbatimit të ligjeve nga ekzekutivi.

Dhe, edhe pse Ministri për Punë dhe Mirëqenie Sociale mungon, kjo tregon edhe vetë arsyen e moszbatimit të këtij ligjit dhe neglizhencën, sidomos kur e prek ndoshta shtresën më të ndjeshme - punëtorët, dhe këtë Drejtorat i cili, kryekëput, merret me këtë punë që quhet Inspektorati i Punës.

Problemet janë shumë mirë të identifikuara, por duhet të konkretizohen me masat shtesë dhe rekomandimet të cilat nxjerr Kuvendi, edhe pse jo rrallë herë, por po shihet që organizatat buxhetore në këtë aspekt tregojnë një neglizhencë nga kjo, sidomos për këtë lëmi, dhe në këtë aspekt ekzekutivi nuk i përfillë rekomandimet e Kuvendit. Prandaj, ndoshta këtu duhet ta kemi një sugjerim shtesë që të përcillet edhe implementimi i rekomandimeve që dalin nga komisionet funksionale.

E para. Problemi kryesor që këtu tregohet, është se përpos ankesës që është për numër të vogël inspektorëve, pika 5 ku thotë, që: “edhe pse ka numër të vogël të inspektorëve, në disa kompani ka vizita të shpeshta”.

Kjo nënkupton se nuk është as më pak as në shumë se keqpërdorim i detyrës zyrtare, e ndoshta edhe lë dyshime për korrupsion, sepse nëse vizitohet një kompani disa herë dhe tjerat nuk kanë kurrfarë mbikëqyrje, atëherë tregon se jo vetëm që nuk përfillen të drejtat e punëtorëve dhe vetëm nuk kryhet detyra ashtu sikur që i takon sipas ligjit, por mund të kemi, dhe të lë dyshime për korrupsion.

Prandaj, kur të jepen edhe rekomandimet, unë i kam disa sugjerime parimore që janë dhe që mendoj që duhet të plotësohen, duke filluar nga rekomandimi 1 ku thotë: “Qeveria e Kosovës, Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale dhe organet e tjera”, që këtu e nënkupton ndoshta komunën përgjegjëse, “duhet të rrisin përpjekjet për zbatimin e ligjit”.

Pra, “jo duhet të rrisin”, por janë të obliguara ta zbatojnë ligjin dhe kjo nuk ka dhe nuk lë alternativë tjetër. Se nëse është “duhet të rrisin përpjekjet” atëherë mbetet në vullnetin e tyre që, sipas vullnetit të tyre edhe sipas angazhimeve edhe e respektojnë ligjin.

Edhe te koordinimi në mes të Ministrisë, Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe kuvendit komunal duhet të jetë rekomandimi shumë i qartë.

Rekomandimi numër 3. Ministria duhet të nxjerrë dhe të harmonizojë udhëzimet administrative me Ligjin e Punës.

Kjo faktikisht, nëse nuk janë të harmonizuara, janë në kundërshtim me ligjin dhe është ë afati kohor për Ligjin mbi Inspektoratin e punës kur është afati kohor për nxjerrjen e udhëzimeve administrative ose të akteve nënligjore.

Prandaj, këtu duhet cekur që Ministria nuk i ka nxjerrë së pari aktet nënligjore dhe duhet të jetë strikt afati kur është sipas Ligjit në fuqi.

Dhe për fund, përpos kërkesës për rritjen numrit të inspektorëve, është ndoshta kërkesë e arsyeshme. Rekomandimi numër 5, nga takimet dhe vizitat që thotë në nivelin qendror dhe lokal, shihet nevoja e plotësim- ndryshimit të Ligjit apo e hartimit të një ligji të ri për Inspektoratin e Punës.

Faktikisht, komisionet duhet ta luajnë edhe rolin e vet sipas Rregullores së punës së Kuvendit. E kanë cekur shumë mirë një rekomandim shtesë që është i panevojshëm, sepse është rekomandimi 5, që buron nga rregulla 73 paragrafi 2, përpos obligimit që e ka Qeveria me e raportuar, këta mund ta kenë iniciativën edhe vetë për plotësim dhe ndryshim të ligjit, nëse Qeveria nuk e sheh të arsyeshme, sepse nëse e kanë identifikuar këta atje problemin që nuk zbatohet ligji kjo nënkupton se atje mungon vullneti për zbatim të ligjit dhe nuk mundën me prituri ose me dhënë një rekomandim që ata vet do ta fillojnë ndryshimin apo plotësimin e këtij ligji, apo hartimin e ri, të një ligji të ri për Inspektoratin e Punës. Janë dy çështje të ndryshme: ndryshim-plotësimi me problemet e identifikuar, apo një ligj i ri për Inspektoratin e Punës.

Prandaj unë mendoj se këto rekomandime duhet të plotësohen dhe të kenë karakter obligativ, jo të jenë në mënyrën e përgjithësuar, sepse do t'i humbë kuptimi edhe mbikëqyrjes së zbatimit të ligjeve, një punë e cila po shihet shumë qartë se është bërë me një disiplinë dhe me një korrektësi nga ana e deputetëve. Ju faleminderit shumë!

KRYETARI: Ju faleminderit! Deputetja Alma Lama e ka fjalën.

ALMA LAMA: Ju faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Ligji i punës është një nga ligjet më të rëndësishme i cili ka të bëjë drejtpërdrejt me jetën e qytetarëve, me njerëzit që punojnë dhe të cilët janë për momentin mjaft të diskriminuar. Pjesa më e madhe e punëtorëve janë mjaftë të diskriminuar dhe ky ligj nuk ka arritur të implementohet.

Me thënë të drejtën, unë kam prituri një raport shumë më të detajuar dhe jo si ky që mu duketë pak si telegrafik, pasi nuk e paraqet gjendjen në të cilën punojnë, pra punëtorët.

Problemi më i madh i punës, ka të bëjë me kontratat. Janë me mijëra punëtorët të cilët punojnë pa kontrata pune. Dhe mendoj se ky është dashur të evidentohet në raport, pra punojnë në të zezë. Shfrytëzohen në mënyrë çnjerëzore, nuk kanë kurrfarë të drejte, hidhen në rrugë kur t'u teket pronarëve pa pikë mëshire, nuk paguajnë kontribut pensioni, madje ka raste kur ka pasur punëtorë të cilët e kanë humbur jetën në vendin e punës dhe për këtë nuk është përgjigjur askush. Dhe, të mos flasim për përfitimin e një pensioni apo një shpërblimi, siç e kanë vendet e tjera, pra që do të mbështeste disi dhe do të kompensonte disi humbjen e jetës së personave.

Natyrisht, të gjitha këto bëhen edhe fal faktit që sistemi gjyqësor nuk funksionon. Por pavarësisht nga kjo mendoj se së paku ne si Kuvend duhet ta themi fjalën tonë shumë më të ashpër në lidhje me këtë çështje.

Një nga gjërat tjera që do të duhej të ishte evidentuar në raport, e që është evidentuar pjesërisht, ka të bëjë me inspektorët të cilët, thuhet në raport, shkojnë shpesh në disa kompani.

Unë do ta them një fakt tjetër. Inspektorët kryesisht i vizitojnë shpesh dhe i ndëshkojnë kompanitë e vogla, dhe jo kompanitë e mëdha. Dhe mos të harrojmë që pjesa më e madhe të kompanive të mëdha janë ato që punësojnë më shumë njerëz dhe këto kryesisht pa kontrata pune, sidomos kompanitë e ndërtimit.

Por, rasti më eklatant është firma Behtel&Enka ku punëtorët shfrytëzohen në mënyrë çnjerëzore, punojnë me orë të gjata dhe paguhet me paga minimale. Çka është më e rëndësishme, e kanë të ndaluar të marrin pjesë në çfarëdo lloji bashkimi sindikal, dhe kjo është shkelje e drejtpërdrejtë e të drejtave të njeriut të cilat janë të garantuara me Kushtetutën e Kosovës.

Madje edhe mediat pengohen për t'i vizituar dhe për të folur me punëtorët që punojnë atje. Këtu e përjashtoj rastin kur kryeministri shkon për vizita dhe mediat shkojnë për t'i bërë reklama.

E thashë që kompanitë private janë kryesisht ato që e shkelin më së shumti Ligjin e punës, dhe po thaj se mungesa e kontratave të punës është bërë rregull në këto kompani.

Pastaj, të mos flasim për kategoritë më të diskriminuara brenda gjithë kësaj - që janë gratë, të cilat vazhdojnë të paguhet më pak se meshkujt për të njëjtën punë. Ky është fenomen. Po kështu, ato diskriminohen edhe në rastet kur sjellin në jetë fëmijë.

Në fund, dua të them se Ligji i punës, i cili është përgatitur në mandatin e kaluar, është një ligj mjaft i mirë. Problemi qëndron tek implementimi, dhe mendoj se duhet të filloj dhe të ndryshoj logjika që kur nuk na përshtatet ligji dhe kur nuk mund të zbatohet, ne duhet të ndryshojmë ligjin. Jo, në fakt, ne duhet të këmbëngulim që ligjet të implementohen dhe në radhë të parë, përgjegjësia këtu i bie Qeverisë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Fjalën e ka deputeti Salih Morina, por kisha lutur që vërtetë me qenë në kuadër të Ligjit se Ligji i Inspektoratit të punës dhe Ligji i punës kanë diferenca mes veti. Pra, është fjala për Ligjin e Inspektoratit të Punës.

SALIH MORINA: Ju faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Mendoj se për pjesën më të madhe, sa i përket këtij Raport, e thanë parafolësit, e njëkohësisht edhe udhëheqja e këtij raporti, por mendoj se janë disa çështje që duhet të prezantohen kur është në pyetje trajtimi i inspektorëve në përgjithësi, do të thotë që janë në kuadër si në nivelin lokal e po ashtu edhe në nivelin qendror, mendoj se inspektorët e punës, në krahasim me inspektorët tjerë janë në një gjendje jo të mirë sa i përket çështjeve të zyrave. Në shumë komuna, do të thotë, edhe në raport është paraqitur por e dhe gjendja është shumë reale që në disa komuna këta inspektorë nuk kanë zyre dhe po ashtu këta inspektorë nuk i kanë edhe mjetet më të nevojshme duke filluar nga inventari dhe gjësendet tjera.

Prandaj, do të ishte mirë që edhe në ato komuna ku nuk ka inspektorë të punës, të insistohet nga Ministria që t'i formojnë inspektorët e punës dhe po ashtu të shihet mundësia që t'iu jepet pasi që është përcaktuar edhe në raport që ka mungesë të inspektorëve, të shikohet mundësia që edhe komunave t'u jepet mundësia të formojnë edhe nga një inspektor në kuadër të buxhetit të vet. Kjo mund të bëhet, do të thotë, nga ana e Ministrisë e cila mund të lejohet me një udhëzim administrativ, siç e kanë edhe ministritë tjera, dhe sikur që është me inspektorin sanitar që është në nivel qendror dhe po ashtu në nivel lokal, e po ashtu edhe me inspektorin e tregut në nivel qendror dhe në nivelin lokal.

Them që trajtimi nuk është i barabartë për arsye se inspektorët e punës kanë përgjegjësi të madhe, njëkohësisht kanë punë shumë të madhe, sepse përpos që e mbikëqyrin sektorin publik, siç është shëndetësia me numër të madh i punëtorëve, e po ashtu edhe arsimin dhe disa, apo jo disa, por pjesën më të madh të ndërmarrjeve publike, ata kanë të bëjnë edhe me sektorin privat.

Prandaj, pagesa për rrezikshmëri, unë mendoj se duhet të futet në rekomandim dhe duhet që Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale të merr hapin dhe rrezikshmëria duhet t'u paguhet inspektorëve të punës, siç e kanë edhe inspektorët e tatimit dhe po ashtu edhe inspektorët e tjerë.

Prandaj, mendoj që rekomandimet të cilat po nxirren, jo vetëm në këtë raport, por edhe në raportet tjera, e thanë edhe parafolësit tjerë, do të ishte mirë që ministritë përgjegjëse t'i implementojnë. Pra, jo vetëm të nxirren rekomandimet e të mos implementohen, sepse një gjë e tillë, do të thotë, në këtë farë forme edhe komisioni i cili po e kryen punën e vet nuk po i vlerësohet puna, prandaj kërkojmë nga ministritë dhe institucionet përkatëse të cilat janë përgjegjëse edhe në kuadër të Ligjit, por njëkohësisht edhe në kuadër të punës së vet dhe të përgjegjësive t'i implementojnë rekomandimet sepse nëse implementohen rekomandimet, atëherë edhe Ligji do të jetë i implementueshëm. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Deputetë, sa i përket Inspektoratit të Punës, nëse ne domi t'i ikim disa deformimeve që u cekën këtu dhe nëse barten nëpër komuna, unë nuk besoj që do hiqen ato dukuri dhe ato çështje negative, prandaj ndoshta kishte me qenë mirë me qenë një inspektorat i nivelit qendror dhe realisht me i kryer punët konform ligjeve që janë në fuqi.

Deputete Breca, a e do fjalën? Urdhëroni! Fjala është për deputeten Nazane Breca.

NAZANE BRECA: Ju faleminderit!

Unë i falënderoj të gjithë për vërejtjet që i dhanë, por desha me cekë se ky nuk ka qenë raport mbi monitorimin e Ligjit të punës, por ka qenë raport mbi monitorimin e implementimit të Ligjit mbi Inspektoratin e Punës, kështu që disa deputetë po më duket i kanë përzier pak gjërat. Ju faleminderit!

KRYETARI: Mirë. Ju faleminderit! Të lajmëruar për diskutim nuk ka. Ka replikë Alma Lama.

ALMA LAMA: Ju faleminderit, kryetar!

Siç e thash, raporti mu duk telegrafik. Inspektoratet e punës respektojnë ose implementojnë Ligjin e punës. Do me thënë, edhe kjo ishte logjika e diskutimit tim.

I rëndësishëm është implementimi i Ligjit të punës dhe këtu ndeshen problemet më të mëdha. Inspektorët janë mjete të cilët duhet përdorur për ta bërë atë. Dhe, prandaj unë edhe kritikova në fjalimin tim inspektorët të cilët shpesh pra bëjnë diskriminim ose shpeshherë janë edhe të korruptuar, sepse shkojnë edhe në kompani të vogla dhe i ndëshkojnë, ndërsa kompanive të mëdha nuk guxojnë tu afrohen. Ju faleminderit!

KRYETARI: Deputetja, Nazane Breca.

NAZANE BRECA: Unë edhe një herë po i them koleges se është kah i përzien kompetencat. Prapë po them se ky është Ligji mbi Inspektoratin e punës. Kaq.

KRYETARI: Mirë. Ju faleminderit! Besoj se u sqaruam për këtë çështje. Për shkak të mungesës së kuorumit për votim, kalojmë në pikën e radhës, që është:

9. Shqyrtimi i Propozim-programit të punës së Kuvendit për vitin 2012.

Programi i punës së Kuvendit për vitin 2012 është hartuar në bazë të programit legjislativ të Qeverisë së Republikës së Kosovës për vitin 2012, të planeve të punës të komisioneve parlamentare për vitin 2012 dhe të Planit të veprimit të Kuvendit për Integrimet Evropiane për vitin 2012.

Programi i punës për vitin 2012, paraqet një dokument bazë për aktivitetin e Kuvendit të Republikës së Kosovës si organ ligjvënës, mbikëqyrës dhe përfaqësues.

Tani do të marrin fjalën kryetarët e komisioneve, pasi kryesisht janë hartuesit më të mëdhenj të këtij dokumenti. Po shkojmë me, sipas lajmërimit që e kemi, me deputetin Arsim Bajrami. A e doni në emër të Partisë Demokratike fjalën? Të Grupit Parlamentar, urdhëro, e ke fjalën.

ARSIM BAJRAMI: Po, për Grupin Parlamentar.

I nderuari kryetar i Kuvendit!

Kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës ...

KRYETARI: Po, a të shkojmë një herë për të komisioneve, e pastaj grupet parlamentare? Atëherë, fjalën e ka kryetari i Komisionit, deputeti Arben Gashi!

ARBEN GASHI: Ju faleminderit, kryetar!

Na e kemi një plan pune këtu, mirëpo duhet të kemi parasysh disa elemente. Dhe, ndër elementet kryesore, është se jemi në një proces reformues të Kushtetutës dhe shumë ligje mund të vijnë për t'u rishikuar, siç janë: Ligji për Këshillin Gjyqësor, Ligji për Këshillim Prokurorial dhe plot ligje tjera që merren, si vijnë si pasojë e reformës kushtetuese, nenit- kompetencat për presidentin. Po ashtu, edhe ligjet tjera mund të vijnë sa i përket përfundimit të pavarësisë së mbikëqyrur, iniciativën për përfundimin e pavarësisë së mbikëqyrur ku mund të ndryshohen disa struktura, kështu që kemi parasysh shumë ligje mund të vijnë edhe mund të mos jetë shumë relevante kjo strategji legislative.

Po ashtu, Komisioni ka marrë vendim që edhe Ligjin për përgjegjësitë e deputetëve ta rishikojmë, sepse ka pasur disa problematika ky ligj dhe jemi në këtë situatë ku këto ligje do të ndryshojnë pothuajse 40% të kësaj strategjie legislative. Dhe, vetëm sa për paralajmërim, po ju njoftoj se kjo strategji legislative këtu është relative, jo ajo që mund të jetë absolute, sepse shpesh kemi pasur presion prej mediave pse nuk është respektuar pjesa e strategjisë legislative, pse nuk janë bërë këto ligje dhe kjo ishte më shumë për sqarim për media se sa për Kuvendin? Sepse, mediat shpesh nuk e kuptojnë se çka është një orientim strategjik për t'i hartuar këto ligje dhe çka është një obligim konkret për t'i respektuar disa ligje. Prandaj, duke marrë parasysh edhe këto tendenca të mundshme të ndryshimeve kushtetuese, mund të kemi edhe ndryshime të mëdha sa i përket strategjisë legislative edhe ligjeve që duhet t'i trajtojmë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Po shkojmë sipas radhës: Komisioni për Buxhet dhe Financa nuk është e domosdoshme ta marrë fjalën, nuk kemi këtu.

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve Pakicë? Nuk e do kurrkush fjalën. Komisioni për Legjislacion e kreu. Komisioni për Integritet Evropian, deputeti Lutfi Haziri e ka fjalën.

LUTFI HAZIRI: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Programi parasheh në kornizë krejt angazhimet që i ka bazuar në agjendën legislative që ka qenë Qeveria dhe do të varet shumë se sa ata e respektojnë, sa do ta respektojnë ata dinamikën e dërgimit të ligjeve dhe procedurave që ka Kuvendi.

Zakonisht, është parë që Qeveria reagon vetëm kur komisionarët e BE-së qojnë letra interne ose zyrtare, bëjnë presion dhe mandej kërkojnë që Kuvendi mu ul në korrik edhe në gusht me kry pjesën e ligjeve. Për mos me ndodh dhe kjo mendoj që një angazhim serioz që disiplinohet Qeveria, le t'i dërgojë me kohë gjitha raportet, do të jetë i domosdoshëm, ndërsa pjesa tjetër sa i përket agjendës së Komisionit për Integriteteve Evropiane, besoj që është harmonizuar me planin e veprimit, por dy probleme mbeten me plotësu. Do të jetë shumë i rëndësishëm për ne rishikimi eventual i buxhetit i edhe rritja e kapaciteteve njerëzore apo e stafit për numrin që e parasheh Plani i veprimit. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Komisionit për Punë të Jashtme, a do dikush fjalën? Jo.

Komisioni për Arsim, Shkencë, nuk e do fjalën.

Komisioni për Ekonomi, Tregti, Zenun Pajaziti e ka fjalën.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, zoti kryetar!

Shkurtimisht dëshiroj ta falënderoj Kryesinë që ka përfshirë gjithë planin e punës së Komisionit për Zhvillim, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri. Është ajo që dëshiroj të përmend këtu, përveç asaj që shumica e projektligjeve që vijnë këtu janë projektligje që vijnë nga vetë Qeveria, të sponsorizuara nga vetë Qeveria, ka një risi. Ju e dini vitin që shkoi kemi monitoruar disa prej ligjeve si Kuvend dhe një prej projektligjeve që tani e kemi sjell për plotësim-ndryshim edhe që është përfshirë vjen pikërisht si rezultat i monitorimit të Kuvendit, të Komisionit tonë dhe po ashtu, në përputhje me rekomandimet që ka aprovuar ky Kuvend.

Pra, kemi risi që vetë Kuvendi në relacion me vetë rekomandimet që i ka nxjerrë, ka prurë ligje për t'i plotësuar dhe për t'i ndryshuar. Faleminderit, shumë!

KRYETARI: Komisioni për Bujqësi, nuk është këtu.

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, nuk është i interesuar.

Komisioni për Administratë Publike, Pushtet Lokal, Media, shkoi.

Komisioni për Punë të Brendshme dhe Siguri, s'është i interesuar.

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, deputetja Suzan Novobërdaliu e ka fjalën.

SUZAN NOVOBËRDALIU: Faleminderit, kryetar!

Edhe unë ju falënderohem për përfshirjen në planin e punës, mirëpo mendoj se këtu duhet të plotësohet edhe me dy raporte e që është Raporti për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Avokatin e Popullit dhe Raporti për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për personat e zhdukur, derisa afati i shqyrtimit mund të jetë muaji maj. Faleminderit, kryetar!

KRYETARI: Faleminderit! Komisioni për mbikëqyrjen e Agjencisë së Inteligjencës s'është këtu.

Komisioni për Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës, nuk e do fjalën.

Komisioni për Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendi, nuk e do fjalën. Atëherë shkojmë te deputetët e lajmëruar tani sipas grupeve.

Në emër të Partisë Demokratike, fjalën e ka deputeti Arsim Bajrami.

ARSIM BAJRAMI: Faleminderit, zoti kryetar!

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike ka shqyrtuar Planin e punës së Kuvendit dhe i jep mbështetje parimore. Vlerësojmë se plani është hartuar në bazë të planifikimit legjislativ që ka bërë Kuvendi i Kosovës, agjendës legislative të Qeverisë dhe planeve të komisioneve.

Megjithatë, ne propozojmë që në vazhdim ky plan të plotësohet, meqenëse viti 2012 do të jetë një vit shumë dinamik për Kuvendin e Kosovës, propozojmë që ky plan në proces, sidomos në sesionin vjeshtor, të plotësohet edhe me pakon e ligjeve që rrjedhin nga reforma kushtetuese dhe reforma zgjedhore e në mënyrë të veçantë deri në fund të vitit, të përfshihet edhe pakoja e ligjeve që është pjesë e procesit të përmbylljes së pavarësisë së mbikëqyrur. Me siguri, që në kohën kur do të jenë të gatshme këto procese, kur ligjet do të vijnë nga Qeveria, Kuvendi do t'i përfshijë në agjendat e sesioneve, miratimin e këtyre ligjeve dhe vlerësoj se ky plan i punës, me këto plotësime që do të ndodhin gjatë këtij viti, bën që ndoshta ky vit i Kuvendit të jetë viti më dinamik në aspektin e miratimit të legjislacionit. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Fjalën e ka kryetari i Komisionit për Mbikëqyrje të Financave Publike, deputeti Ali Sadriu.

ALI SADRIU: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar kolegë,

Komisioni për Mbikëqyrje të Financave Publike gjatë punës së vet ka vërejtur dhe ka bërë një kërkesë, ka vërejtur se ka një nevojë për plotësim-ndryshim të Ligjit për Zyrën e Auditorit të Përgjithshëm dhe ne kemi adresuar një kërkesë të kësaj natyre në takimin me ju ku ishim prezentë, kryetarët e komisioneve, u dakorduam që të rekomandojmë që Qeveria ta hartojë një plotësim-ndryshim të këtij ligji dhe t'ia sjellë Kuvendit.

Unë nuk e pash në këtë plan pune, prandaj e mora fjalën që të marr informacione dhe të insistojmë pse nuk është dhe cilat janë mundësitë që ai të jetë edhe ta kem një ligj të tillë?

KRYETARI: Faleminderit, deputet!

Realisht, Qeveria s'e ka prurë në agjendën e saj legislative për vitin 2012. Unë mendoj që Komisioni ka të drejtë të formojë grupin e punës dhe ta amendamentojë ligjin. Edhe kështu mund t'ia bëjmë, por neve si Kuvend nga Qeveria nuk na ka ardhur ky ligj të

cilin ti po e kërkon. Ne mund të kërkojmë nismën, por nisma mund të vijë edhe nga Komisioni. Jam që të bëhet, por realisht ne mund ta kërkojmë nga Qeveria, por nismën mund ta bëjë edhe Komisioni. Vazhdojmë!

Në emër të LDK-së deputeti Armend Zemaj e ka fjalën.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, kryetar!

Më lejoni të them që ky plan i paraqitur është ambicioz. Të jem i sinqertë, mendoj që ndoshta edhe i tejkalon edhe mundësitë edhe kapacitetet e Kuvendit, ku jo rrallë herë edhe jemi kritikuar për miratimin e shpejtë të ligjeve dhe të projektligjeve dhe mendoj që në këtë aspekt edhe Kryesia edhe komisionet dhe grupet parlamentare, pa anashkaluar, duhet të kenë kujdes të veçantë.

Forcimi i rolit ligjvënës edhe mbikëqyrës, si dhe krijimi i marrëdhënieve aktive me publikun të Programi i punës të Kuvendit për vitin 2012, duhet të plotësohet edhe me dëgjimet publike të komisioneve, por edhe të jetë si pikë mbikëqyrja e zbatueshmërisë së ligjeve. Këtë po e them, sepse e përmendi edhe kryetari i Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike, ku komisioni pak kohë më parë nga monitorimi i Ligjit për Zyrën e Auditorit Gjeneral ka dal me rekomandim që ligji të ri hartohet apo të vijë me plotësim-ndryshim nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe nuk është me këtë agjendë.

Dhe e dyta, po ashtu, ligjet që atakohen nga Gjykata Kushtetuese, siç është rasti me Ligjin për përgjegjësitë dhe të drejtat e deputetëve dhe duke marrë parasysh suspendimin e neneve të caktuara, por edhe ajo çka kemi miratuar në Komisionin funksional për Legjislacion, si pjesë e programit të punës, duhet të figurojë në agjendën legjislative sipas mundësive të jetë së paku në sesionin vjeshtor dhe kjo punë të përfundojë. Dhe e dyta, është Ligji për Qeverinë e Republikës së Kosovës, ku është tërhequr nga një seancë dhe është paraqitur që ky të vijë në lexim të dytë në shkurt dhe akoma nuk kemi një sqarim, as nga Komisioni, as nga Kryesia, por as nga vetë Qeveria se çka do të bëhet dhe çka do të ndodhë. Janë këto ligje që janë bazike për funksionimin edhe të trupave punues të Qeverisë, por edhe të vetë legjislativit. Prandaj, mos të mbesin këto vetëm ajo ambicie e sinqertë e deputetëve dhe e Kuvendit për realizimin e detyrave sipas Kushtetutës dhe mandatit që e kanë, por këto të konkretizohen me punë aktive dhe me nxjerrjen, por edhe atë për çka është Kuvendi i Republikës së Kosovës, roli ligjvënës, mbikëqyrës, të cilit i takon sipas mandatit.

Ne e përkrahim këtë program të punës dhe besojmë dhe përmes Grupit Parlamentar do të angazhohemi që të plotësohet konkretisht.

Faleminderit, shumë!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të “Vetëvendosjes” deputetja Albulena Haxhiu e ka kërkuar fjalën.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit, kryetar!

Fillimisht, thuhet që ky propozim për Programin e punës është bazuar edhe në planet e punës së komisioneve parlamentare, mirëpo kemi vërejtur që jo gjitha planet e punës së komisioneve janë marrë parasysh dhe nuk e di se pse.

Mendoj që është dashur të koordinohen komisionet më mirë me Kryesinë e Kuvendit, apo Kryesia me komisionet. Gjithashtu, në këtë plan- program parashihen disa ligje për ndryshim-plotësim, të cilat janë miratuar në vitin 2011 dhe krejt kjo është si pasojë e votimit të ligjeve shpejt e shpejt, pa pasur mundësi të analizohen aq sa duhet. Më pastaj, edhe në vitin 2011 Qeveria na ka sjell një program legjislativ shumë ambicioz, të cilin nuk ka mundur ta realizojë vitin e kaluar, kjo edhe njëherë tregon papërgjegjësinë, por edhe dështimin e kësaj Qeverie.

Sidoqoftë, ne do të votojmë për këtë plan- program duke e ditur rëndësinë që ka, edhe pse ka shumë mangësi në hartim, por do të ketë mangësi edhe në zbatim. Faleminderit!

KRYETARI: Jemi duke folur për Programin e punës së Kuvendit për vitin 2012, respektoni rendin e ditës.

Fjalën e ka deputeti Ardian Gjini, në emër të Grupit Parlamentar Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryetar!

Meqenëse kemi sistem të demokracisë parlamentare, definitivisht se puna e Kuvendit varet prej prezantimit të Planit legjislativ të Qeverisë, kjo definitivisht edhe po ndodh në shumë vitet të cilat i kemi lënë prapa, mirëpo jo domosdoshmërisht ka sjell punë efektive edhe në Kuvendin e Kosovës.

Mund të them se që disa vite agjenda legjislative e Qeverisë nuk është fare agjendë, por është një grumbull i ligjeve i cili sillet edhe ajo agjendë tani e determinon plotësisht planin e punës ose programin e punës së Kuvendit të Kosovës, i cili nuk po mund të realizohet ashtu si duhet. Dhe në fund të fundit, barra i bie Kuvendit, definitivisht për shkak se ky Kuvend edhe e ka zgjedhur Qeverinë, definitivisht, jo me votat tona mirëpo e ka zgjedhur. E kemi parë edhe në vitet që kanë shkuar se nuk mund të parashihet asgjë në Kosovë, domethënë, na ka ardhur një buxhet i cili është votuar në fund të vitit të kaluar dhe ai buxhet ka paraparë shpenzimet për vitin 2012. Tani jemi në shkurt dhe efektivisht nuk i kemi as dy muaj e gjysmë që prej kohës kur është votuar buxheti dhe nëse dikush e sheh planin legjislativ që e ka sjell Qeveria dhe programin e punës së Kuvendit, i cili bazohet në atë plan, kryesisht, del se ka diskrepansë të madhe.

Do të thotë, Qeveria e Kosovës nuk po mund të planifikojë as dy muaj përpara, domethënë, qeveritë normale planifikojnë me vite përpara, ndërsa Qeveria jonë nuk po mund t'i harmonizojë punët e vet edhe legjislacionin të cilin e sjell në Kuvend, as vetëm për dy muaj. Mos harroni se gjatë gjithë vitit po votojmë ligje, sikur një që e votuam sot, të cilët kanë efektet direkt në buxhetin e Kosovës dhe definitivisht kemi mos harmonizim të ligjeve. Sidoqoftë, Aleanca nuk e ka në plan që t'i bëhet pengesë aprovimit të Planit të punës Kuvendit të Kosovës, i cili definitivisht se i përfshin edhe aspektet tjera siç janë-Plani i veprimit për Integrim Evropian. Ne do ta votojmë këtë plan të punës së Kuvendit,

mirëpo me këtë nënvizim të cilin e bëra unë deri më tani se barra po i mbetet Kuvendit edhe duhet t'i mbetet Kuvendit për shkak se ky Kuvend, pa votën e Aleancës e ka zgjedhur Qeverinë e Kosovës, e cila Qeveri nuk është e aftë të planifikojë as dy muaj përpara. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar Koalicionit për Kosovë të Re, kush e do fjalën?
Deputetja Myzejene Selmani e ka fjalën.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, kryetar!

Duke marrë parasysh se çdo vit brenda Kuvendit të Kosovës apo sesionit pranveror dhe vjeshtor miratohet Programi i punës së Kuvendit të Republikës së Kosovës, në këtë plan shihet që kemi një numër të ligjeve, mirëpo është fatkeqësi që këtu sot nuk janë në seancë ministrat, të cilët i kanë planifikuar këto projektligje që të miratohen brenda Kuvendit të Kosovës.

Si plan mund të përkrahet, mirëpo sugjerimi im kish me qenë edhe pse s'është Qeveria këtu është vetëm njëri zëvendëskryeministër dhe ministër, kish me qenë se a është e rrugës që disa ligje janë ndoshta shumë të mira, dhe insistohet të hyjnë në plotësim-ndryshim, pa pasur nevojë, ndërsa ka mungesë të disa ligjeve të tjera të cilat u duhen qytetarëve të Kosovës. Në parim e përkrahim Planin e punës së Kuvendit, mirëpo me sugjerim që Qeveria të ketë në dijeni që jo vetëm të sjellë ligje plotësim-ndryshim, pa pasur nevojë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të SLS-së deputetja Jasmina Zhivković e ka fjalën.

JASMINA ŽIVKOVIĆ: Zahvaljujem predsjedavajući!

Predloženi plan i program rada Skupštine za 2012. godinu je prilično aktivan i zahtevaće maksimalnu angažovanost celokupne Skupštine u realizaciji ovog plana i programa. Uz verovanje da postoji realna mogućnost za realizaciju predloženog plana i programa podržavamo ovaj plan i program za 2012. godinu. Hvala!

KRYETARI: Në emër të grupit „6+” nuk ka të lajmëruar.

Atëherë, shkojmë sipas radhës.

Fjalën e ka deputetja Sala Berisha-Shala.

SALA BERISHA-SHALA: Faleminderit!

I nderuar kryetar i Kuvendit!

Të nderuar kolegë deputetë, ju të pranishëm,

Kuptohet që Propozim- programi i punës së Kuvendit për vitin 2012 është i bazuar në Planin e punës së komisioneve parlamentare, të cilat komisione kanë hartuar planin e punës, bazuar në strategjinë legjislative që e ka sjell Qeveria në Kuvend. Unë po ndalem kryesisht te plani i punës së Komisionit për Zhvillim Ekonomik dhe këtu bie në sy në përgjithësi një përqindje më e madhe e këtij plani janë projektligjet të cilat na vijnë për ndryshim dhe plotësim dhe numerikisht ky komision, në këtë vit duhet të merret me

trajtimin, me amendamentimin e 24 ligjeve, prej tyre 20 janë që vijnë për ndryshim dhe plotësim dhe vetëm katër ligje janë që vijnë për herë të parë në Kuvend dhe e plotësojnë një boshllëk të madh që i ka munguar infrastrukturës ligjore. Dhe ato katër ligje vijnë, dy janë nga Ministria e Infrastrukturës, një nga Zyra e Kryeministrit dhe një është nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë.

Vërtet duhet ndoshta një analizë pse e përshkon planin e punës më shumë ligjet për ndryshim dhe plotësim. Këtu mund të vijnë në shprehje disa arsye, sepse jemi në një pozicion tjetër si Kosovë, si shtet, duhet të plotësohen dhe të ndryshohen ligjet e pakos së Ahtisarit, ajo çka është nën 1. Mandej një element tjetër që duhet pas parasysh pse vijnë, i kemi disa prej ligjeve që unë kam mundur të identifikoj që është hera e tretë që i nënshtrohen plotësimit dhe ndryshimit dhe mendoj që të mos përsërisim në vit pas viti me plotësime dhe ndryshime të ligjeve, duhet që me Rregulloren e punës së Kuvendit, meqenëse tani është në fazën e amendamentimit, t'u jepet mundësia deputetëve që të merren me trajtimin edhe të atyre neneve, të cilat Qeveria nuk i ka paraparë që të plotësohen dhe të ndryshohen edhe të mos na vijnë vit pas viti që të trajtohen nenet, domethënë, një pjesë e neneve një vit, një pjesë e neneve tjera, në vitin tjetër.

Kështu që, tërheq vëmendjen e Komisionit, i cili është duke u marrë me amendamentimin e Rregullores së punës së Kuvendit që t'i lejojë të kenë qasje deputetët, në qoftë se ata e shohin të arsyeshme edhe të nevojshme që të plotësohet, ndryshohet edhe ndonjë nen të cilin Qeveria nuk e ka paraparë. Mendoj që zbatimit i këtij plani do të jetë shumë fleksibil si në kohë ashtu edhe në pasurimi e këtij plani gjatë vitit, sepse siç e cekën edhe deputetët tjerë, që kemi tani në plotësim e ndryshim edhe Kushtetutën edhe ligjet tjera, të cilat sigurisht që rrjedhimisht do të kenë për pasojë edhe mundësinë e ardhjes në Kuvend të ndonjë ligji tjetër.

Përndryshe e mbështesim, edhe Komisioni, po edhe Kuvendi do të ketë mjaft punë në këtë vit. Vetëm Komisionit për Zhvillim Ekonomik, po i bie se për një muaj të merret me trajtimin e dy ligjeve për menjëherë duke pasur parasysh edhe shqyrtimin e strategjive, monitorimin e ligjeve tjera e kështu me radhë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Fjalën e ka deputeti Sabri Hamiti.

SABRI HAMITI: Faleminderit, zotni kryetar i Kuvendit!

Kolegë të nderuar,

Ky është një propozim-programi i punës së Kuvendit për vitin 2012. Ju e dini, herën tjetër, vitin e kaluar kemi aprovuar një propozim të tillë, programi që është mbështetur në kalendarin e projektligjeve që vijnë nga Qeveria dhe kemi parë që ai kalendar nuk ka mund të jetë preciz, kështu që Programi i punës së Kuvendit nuk ka mund të jetë, po ashtu preciz.

Edhe kësaj radhe do të ndodhë kjo, pa marrë parasysh që kemi një regjistër të ligjeve që do të vijnë nga Qeveria dhe një kohë të shëjuem kur do të vijnë, në absolutisht nuk jemi

të sigurt që vijnë në ato data, ndërsa programi, natyrish, është mbështetur në shënjimet që kanë dhënë ata.

Prandaj, unë propozoj që meqë është kjo kështu dhe ashiqare që është variabile puna që varet nga dikush tjetër e në këtë rast varet Kuvendi, nga sponzorimet e ligjeve të Qeverisë, të përpiqemi të fokusohemi në këtë çka ndodh në këtë sesion të Parlamentit, që është sesioni dimëror, në mënyrë që të rimerremi saktësisht me këtë problematikë edhe në qershor. Domethënë, mos të pretendojmë që tash ky program do të jetë i vlefshëm deri në dhjetor, po gjithësesi të merremi edhe një herë në qershor, të shohim çka ka ndodh brenda këtij afati dhe çka presim dhe çka mbetet, sepse do të ndërrojë kalendari.

Përpos kësaj, unë mendoj që nuk mund të jetë precize kjo që është përforcuar për muaj, ndonëse është një aspiratë, se po e zëmë Projektligji për Qeverinë, nuk e di, nuk jam i sigurt, a do të kalojë në shkurt, për shembull që ne e kemi të shkruar në shkurt?

Dhe, po shkoj tutje, i kam tre-katër ligje që jam përpjekur t'i shoh të rëndësisë të veçantë dhe të vendosura në një kalendar, që do të mund të ndryshohet, qoftë si kërkesë e Kuvendit ndaj Qeverisë, ose si ligje të rëndësisë të veçantë për këtë vend, që të krijohet një përsheptim i hartimit të tyre. Për shembull, Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ... numër 52, në faqen 11, të jem krejt i saktë edhe me çka kemi, për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për parandalimin e shpëlarjes së parave dhe për, kisha thënë, parandalimin e financimit të terrorizmit, se formulimi thotë krejt diçka tjetër, nëse lexohet çka shkruan këtu, po qëllimi është parandalimi. Ky propozohet që të kalojë në maj, domethënë, unë mendoj që ligjet e tilla duhet të ngutemi t'i kalojmë më shpejtë.

Tutje, ligji numër 74, në faqen 15, që ka të bëjë me kryeqytetin e Kosovës, Prishtinën. Këtu është një histori me këtë ligj. T'ju them të drejtën unë kam filluar të fitoj përshtypjen, që i gjithë rrjeti politiko-institucional nuk ka dashur ta bëjë këtë ligj. I gjithë thashë, pa përjashtim, se s'ka kuptim që të kalohet në tri legjislatura një ligj edhe të bëhet si Ura e Shenjtë, kurrë mos të dihet ku filloi e ku mbaroi. Ky ligj është propozuar kësaj radhe, që të vijë në maj. Unë mendoj që ky duhet të vijë ose në këtë seancë, domethënë, në këtë pjesë të seancave të gjysmëvitit, që të kryhet ose të kalojë në tjetrin, mos të mbetet me shumë të panjohura.

Tutje, ligji nr. 96, në faqe 19, për konfiskimin e pasurisë së fituar në mënyrë të kundërligjshme, afati i dorëzimit thotë është qershor. Unë mendoj që ky ligj edhe është kërkuar. Të gjitha raportet e huaja, është kërkuar edhe brenda në Kuvend edhe në institucione të Kosovës, nuk ka logjikë që të dorëzohet në qershor e ne kemi thënë që ligjet që dorëzohen në qershor, kalojnë në seancat vjeshtore të Parlamentit. Ky duhet të vijë më herët, nëse e kemi ndërmend ta kalojmë një ligj të rëndësisë së veçantë.

Tutje, ligji 145, që është në faqen 29, të këtij programi, ka të bëjë me ndryshimin dhe plotësimin për investimet e huaja, propozohet të dorëzohet në tetor, që i bie edhe me nguti të mëdha, me efikasitet të kalohet deri në dhjetor, që s'e besoj. Unë mendoj që ky ligj duhet të hartohet dhe të vij shumë më herët, të vij para qershorit, të kalohet në këtë pjesë të vitit, se ky vend ka nevojë, nëse ky ligj duhet të plotësohet, që të plotësohet që sa më shpejtë.

Ligji për deputetët duhet të rimerret, sepse edhe ashtu është i hartuar nga Kuvendi dhe le të rimerret komisioni, sepse kemi një ligj që është i anuluar në disa nene dhe tanimë nuk është e sigurt cilat nene funksionojnë, cilat jo.

Dhe, në fund Rregullorja e Kuvendit duhet, se është e jona, edhe ajo varet prej nesh, të kryhet sa më shpejtë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Fjalën e ka deputeti Albin Kurti.

ALBIN KURTI: Faleminderit!

Mendoj se është e vlefshme që para kësaj strategjisë për vitin 2012, ta kemi sadopak një reflektim parimor për vitin 2011 të Kuvendit tonë. Përshtypja ime është që tepër shumë ligje po trajtohen brenda një seance dhe duke pasur parasysh që janë paraparë 152 projektligje, mund të vijnë edhe të tjera në ndërkohë dhe meqenëse i kemi vetëm dhjetë muaj prej të cilëve, natyrisht që duhet të përfshihen aty edhe pushimet, atëherë del që sërish do t'i kemi 4, 5 apo ndoshta edhe 6 projektligje për seancë.

Mendoj që trajtimi i 5-6 projektligjeve deri në 12 projektligjeve, siç e kemi pasur në vitin e kaluar e ka shndërruar Kuvendin në një makineri votimi, që më parë ka shërbyer për legjitimimin e vullnetit të Qeverisë e jo për përfaqësimin e vullnetit të popullit. Kjo shumësi e madhe e projektligjeve e ka shkurtuar debatin, sepse të gjithë deputetët kur dinë që janë 7, 8, apo nganjëherë edhe mbi 10 projektligje për seancë, atëherë diskutojnë shumë më shkurt dhe gjithçka bëhet më formale.

Kështu që mund të thuhet që si organ ligjvënës ne po punojmë shumë në kuptimin e shumësisë së ligjeve që miratohen dhe kjo pritet edhe për vitin 2012, si organ mbikëqyrës po punojmë pak në kuptimin që ka pak interpelanca, nuk ka komisione hetimore parlamentare dhe jo pak qeveritarë nuk u përgjigjen zakonisht ftesave të komisioneve përkatëse.

Në fund desha të them që posa të lexohen projektligjet e propozuara për vitin 2012, krijohet përshtypja që Kosova është vend turistik me disa probleme sociale. S'ka fare projektligje për zhvillim industrial dhe as për prodhim vendor. Pra, s'kemi shtet zhvillimor në Kosovë, s'kemi politika zhvillimore e rrjedhimisht as projektligje në atë frymë.

Mendoj, që kjo është edhe një dëshmi tjetër pse edhe në vitin 2012, Kosova do të mbetet shtet i dobët. Faleminderit!

KRYETARI: Për sqarim, realisht, Parlamenti ynë punon pak. Në seancat parlamentare miratohen ligjet, diskutohen ligjet për të cilat duhet të diskutohet, por ligjet përgatiten në komisione. Dhe, unë mendoj që në seanca duhet të miratohet puna e Kuvendit, që bëhet jashtë seancave. Seanca i merr vendimet dhe legjitimon punën e komisioneve. Ne duhet

të miratojmë më shumë ligje se sa kemi miratuar dhe se sa miratojmë edhe brendapërbrenda një seance.

Fjalën e ka deputeti Hydajet Hyseni, le të përgatitet deputetja Valbona Dibra.

HYDAJET HYSENI: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Unë kam vetëm dy sugjerime, natyrisht që programin e mbështes, po vërej që ka një mosshpërndarje adekuatë të projektligjeve nëpër komisione. Në Komisionin, ta zëmë, për Punë të Jashtme, në të cilin jam, pothuajse nuk ka asnjë obligim.

Edhe Ligji për mërgatën edhe Ligji për parandalimin e terrorizmit e tjera, i janë dhënë komisioneve tjera dhe Komisioni i Jashtëm, praktikisht, nuk ka punë dhe mendoj që nuk është në rregull. Sugjeroj që të praktikohet edhe ajo që me Rregulloren tonë është e lejuar, që për çështje të caktuara të angazhohen edhe dy komisione. Ne nuk i kemi praktikuar.

Dhe vërejtja e dytë ka të bëjë me një mangësi të madhe që është në legjislacionin tonë, te aktet nënligjore ose ai që quhet legjislacioni substituar. Dhe mendoj që është rast për ta shfrytëzuar, që të kërkohet prej ministrive përkatëse që t'i kushtojnë më shumë kujdes këtij obligimi të tyre. Si ilustrim do të merrja Ligjin për të drejtat e ish të burgosurve politikë, i cili me vonesë të madhe po e fillon zbatimin, por varet tash prej ministrive, nëse ato do të plotësojnë obligimin e tyre për të nxjerrë aktet e duhura nënligjore, në mënyrë që ky ligj të mund të zbatohet. Propozoj që edhe për këtë ligj të planifikohet një mbikëqyrje parlamentare për zbatimin e tij. Mendoj që ka edhe një arsye të veçantë, sepse është ligj që është miratuar nga vetë Kuvendi dhe nga deputetët e Kuvendit edhe është hartuar edhe miratuar. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Pajtohem më këtë të fundit, po me atë më herët... do të thotë ky plan i punës së Kuvendit është miratuar nga planet e komisioneve dhe realisht, është çështja e komisioneve se si e organizojnë punën e tyre. Prandaj, ne si kryesi nuk mund t'iu biem ligje komisioneve në mënyrë të barabartë, se edhe punët e komisioneve janë të ndryshme.

Fjalën e ka deputetja Valbona Dibra dhe është diskutuesja e fundit.

VALBONA DIBRA: Faleminderit!

I nderuar kryetar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Pas shqyrtimit të Propozim- Programit të punës së Kuvendit për vitin 2012 kam vërejtur se plotësim- ndryshimi për Ligjin e Zyrës së Auditorit Gjeneral nuk është përfshirë në këtë program.

Dua t'ju rikujtoj se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike në seancën plenare, të mbajtur më 22 shtator 2011, ka paraqitur raportin me rekomandime për mbikëqyrjen e

zbatimit të Ligjit së Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm. Me qëllim të rritjes së nivelit të zbatimit të ligjit, për themelimin e Zyrës së Auditorit Gjeneral, Komisioni ka dhënë rekomandimin. Citoj: “Qeveria e Republikës së Kosovës të përfshijë në agjendën legislative plotësim- ndryshimin e ligjit nr.03/L-075, për themelimin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm dhe Zyrës së Auditimit në Kosovë. Raporti me rekomandim është votuar në seancën e 22 shtatorit të vitit 2011. Prandaj, Grupi Parlamentar i PDK-së e përkrah kërkesën e Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike, që Qeveria të fut në agjendë Plotësim-ndryshimin e ligjit për themelimin e Zyrës së Auditorit Gjeneral. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputete!

Po, është mirë, vërtet deputetët t’i dinë detyrat e veta. Është një e vërtetë e madhe se Qeveria është sponsoruesi kryesor i ligjeve, po edhe grupet dhe komisionet parlamentare mund të amendamentojnë ligje. Nëse nuk e ka prurë në programin e vet Qeveria, atëherë, komisionet apo grupet parlamentare apo grupe deputetësh, le të propozojnë një amendamentim të ligjit, le ta bëjnë ata dhe le ta sjellin në Kuvend. Kjo është rruga, nuk është vetëm Qeveria sponsoruese, kështu që komisionet kanë mund t’i hartojnë edhe t’i fusin në Projekt-programin e Kuvendit, pa qenë nevoja tash komisionet të kërkojnë punë, se kurrkush s’i ka penguar komisionet për ta monitoruar zbatimin e ligjit në një segment të caktuar. Këto janë çështje që vetë komisionet kanë mund ta bëjnë. Ne e kemi sjellë në Kuvend atë që na ka prurë Qeveria dhe komisionet, që e kanë përgjegjësinë kryesore për t’u marrë me ligje.

Nuk kemi të lajmëruar më për diskutim. Në sallë kemi 75 deputetë.

Nëse jeni dakord, shkojmë dhe në shqyrtimin e pikës së fundit

10.Shqyrtimi i kërkesës së Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, për afat shtesë për të shqyrtuar Projektligjin për regjistrimin dhe evidencën e të papunësuarve dhe punëkërkuesve.

Në bazë të nenit 57, pika 7 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, ka kërkuar nga Kuvendi afat shtesë për shqyrtimin e Projektligjit për regjistrimin dhe evidencën e të papunësuarve dhe punëkërkuesve.

Komisioni ka kërkuar afat shtesë, ne me një votim jemi për t’i dhënë një afat shtesë , sipas Rregullores kemi të drejtë t’i japim 30 ditë. Dhe, unë jam që me një votim formal, ta miratojmë këtë kërkesë të Komisionit.

Kush është “për” ?

Faleminderit!

A ka kundër? Nuk ka!

Abstenim? S’ka!

Pra, miratohet kërkesa e Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale.

Tani kthehemi në pikën e tetë, vetëm për ta votuar.

8. Raporti i Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Inspektoratin e Punës.

Ne e patëm në diskutim që ta miratojmë këtë raport të Komisionit. Prezent kemi 75 deputetë. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash.

Kuvendi me 66 vota “për”, 1 “kundër”, 2 abstenime, miratoi Raportin e rekomandimit të Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale për mbikëqyrjen e Ligjit për Inspektoratin e Punës.

Gjithashtu e kemi edhe pikën vijuese, sa për votim.

9. Shqyrtimi i Propozim-Programit të punës së Kuvendit për vitin 2012

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim dhe para se të votojmë te Programi i punës së Kuvendit për vitin 2012, do të plotësohet edhe me - janë shtatë pika, unë mendoj që duhet t’i shtohet edhe pika e tetë- projektligjet lidhur me përfundimin dhe mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë. A jeni dakord për këtë? Faleminderit!

Atëherë, shkojmë në votim. Votojmë tash.

Me 59 vota “për”, 1 “kundër”, 4 abstenime, Kuvendi miratoi Programin e Punës së Kuvendit për vitin 2012.

Dhe, me këtë e kemi përfunduar seancën.

Mirupafshim në seancën e nesërme!

* * *

Përgatiti:

Njësia për Transkriptim dhe Lekturim